



PUNONI, SE DO TË SHIHET PUNA JUAJ

Që të gjithë punojnë, që të gjithë bëjnë aktivitete por të paktë janë ata që japin tërë mundësitë për të kryer një vepër si është më mirë. Kam për qëllim të gjitha veprat e mira, ato të përditshmërisë, më të rrallat por edhe ato me të cilat njeriu e vulos periudhën në të cilën ka jetuar. Nuk është kuptimi i drejtë të thuhet se nuk duhet derdhur të gjitha aftësitë dhe mundësitë për shumë prej veprave. Kjo fjali do të ishte e drejtë vetëm nëse thuhej kështu: Nuk duhet derdhur mundësitë më të mëdha për një vepër të vogël apo ndoshta edhe të gabuar, sikurse të marrësh borxh për ta nderuar mysafirin, ndërsa familja ende s'ka gëzuar asisoj nderimi nga ana jote; apo të japësh mundësitë minimale për një aktivitet vendimtar në jetën tënde, sikurse të shkosh në xhami vetëm njëherë në javë, ndërsa besimi yt duhet ushqyer çdo ditë. Pra, secilit aktivitet t'i japësh hakun që e meriton, sepse krahas asaj se do të përfitosh ti, edhe Allahu do të jetë i kënaqur. Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Vërtet Allahu, ka dëshirë kur ndonjëri nga ju bën një vepër, ta përkryejë atë"*. Dikujt mund t'i shkojë ndërmend se janë për qëllim vetëm ato vepra që kanë të bëjnë kryekëput me Fenë, por jo, Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, nuk caktoi ndonjë kriter të atyre veprave, përveç kriterit thelbësor i cili nënkuptohet, që ajo vepër të jetë e dobishme dhe e lejuar.

Por, jetojmë në një shoqëri ballkanike, e cila shpeshherë nuk di apo nuk do t'i vlerësojë aktivitetet e mira, nga të cilat përfiton edhe lagjia, qyteti madje edhe shteti. Nëse një gjë e tillë vjen prej disa të paskrupullt s'ndërron gjë, por nëse sjellje të atillë kanë edhe "dashamirët", shumëkush do të mërzhitet dhe do ta kapë një plogështi, pas të cilës shumë zor e ka të vazhdojë projektet dhe aktivitetet e dobishme. Të vetmen rrugëdalje fillon ta sheh vetëm nëse bëhet sikur ata, me arsyetimin se askush nuk e vlerëson dhe askush nuk është mirënjohës ndaj tij për veprat që i bën, kështu që do përqendrohet vetëm në një gjë, të fitojë sa më shumë para pavarësisht se në çfarë mënyrë e bën atë, me kamatë, vjedhje, fshehje, mashtrim etj.

Rrugëdalja e vërtetë është kjo: të përqendrohemi në këtë besim, i cili na bën të rehatshëm në çdo situatë. *"E çuditshme është puna e besimtarit, e gjithë çështja e tij është vetëm mirësi, kur përjeton diçka që pëlqen, e falënderon Allahun dhe kjo është mirësi për të, si dhe kur e godet diçka që nuk e pëlqen, bën durim dhe sërish gjen mirësinë"* – kështu na sqaron Pejgamberi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të. Pastaj, t'i përveshim krahët dhe me një vullnet edhe më të madh t'i vazhdojmë punët që t'i arrijmë synimet tona në dynja dhe ahiret. Nëse dikujt i vlerësohen punët e mira, punuesi gëzohet, por nëse nuk i vlerësohen sot, le të mos mërzhitet sepse sigurisht nesër besimtarët do t'i shohin ato vepra dhe do të jenë mirënjohës. Kështu ka garantuar Krijuesi i qiejve dhe i tokës: ***"Dhe thuaju: Punoni, sepse Allahu, i Dërguari dhe besimtarët do të shohin punën tuaj dhe pastaj do të ktheheni tek Ai që di të fshehtën dhe të dukshmen dhe do t'ju tregojë se çfarë keni punuar"***.

Në emër të redaksisë:

Omer BERISHA

AKTUALE

Pas Bombeit qëndron Kashmiri **3-5**
Tendencat globalizuese panevropiane dhe logjika e pushtetit **6-8**
Shqipëri: Allahu i ndaluar?! **8-11**
Dhunimi i grave – ligji islam **12-15**

KËNDI IM

Portreti i një udhëtari **16-18**
Bankat islame... shpëtim nga kriza ekonomike? **18-20**
Përjetime nga Haxhi... **21-23**

AKIDE

A janë veprat kusht i domosdoshëm për imanin, apo janë vetëm kusht plotësues? **24-27**

FIKH

Adhurimi jonë gjatë dimrit **28-32**

AVANCIMI PERSONAL

Bilanci vjetor i myslimanit **32-35**

FAMILJA

Lindja e vajzës – hidhërim apo gëzim **36-38**
Ligji ndërkombëtar për fëmijët vs. familja muslimane **39-43**

TEFSIR

Koha, begati apo ndëshkim **44-46**

HADITH

I nxehti dhe i ftohti i xhehenemit **47-50**

LIBRI

Ngjarjet e popujve të hershëm **51-52**

FETVA DHE KONSULTIME

Fetva dhe udhëzime rreth stinës së dimrit **53-55**

HISTORI

Musai Alejhi Selam dhe dita e Ashuras **56-60**

REDAKSIA

Omer BERISHA – kryeredaktor
Anëtarë të redaksisë:

Ahmed KALAJA, Bekir HALIMI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Ali SHABANI, Ismail BARDHOSHI, Talha KURTISHI, Bledar HAXHIU, Sedat SHABANI, Agron TERZIQI, Lulzim SUSURI, Genc PLUMBI, Zeki ÇERKEZI, Enver AZIZI, Bashkim BAJRAMI, Bilal TEQJA.
Bashkëpunëtorë: Ekrem AVDIU dhe ENIS RAMA
Roald HYSA – redaktor gjuhësor
Halil BERISHA – redaktor teknik
Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio) - ballina
Sedat RAMADANI - shpërndarje dhe marketing

Boton: AlbIslam

Adresa: rr: 110 nr: 5 | Çarshia e vjetër | Shkup 1000
email: revista@albislam.com
sms: +389 75 436 718 | fax&tel: +389 2 3230 827
Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250
Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro (në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com
ALBISLAM DOOEL
Xhirollogaria: 300000002770453
Komerçijalna Banka A. D. – Skopje
Numri tatimor: 4030008038784
Abonimet me euro mund t'i bëni online nëpërmjet shërbimit PAYPAL. Të dhënat mund t'i gjeni në www.albislam.com

PAS BOMBEIT QËNDRON KASHMIRI

Kashmiri është shteti i vetëm me shumicë myslimane. Muslimanët e Kashmirit kërkojnë pavarësi prej Indisë që nga viti 1947. Zgjedhja e preferuar është bashkimi me Pakistanin, kurse një pakicë e rëndësishme pretendon për një pavarësi totale

ERIC S. MARGOLIS

Organizata strategjike amerikane e respektuar RAND Corp., parashihte që një shkëmbim zjarri nuklear mes Indisë dhe Pakistanit do të vriste dy milion njerëz, do të plagoste njëqind milion të tjerë dhe do të shpërndante rreze radioaktive përgjatë gjithë globit.

Ky parashikim u bë para dhjetë vjetësh. Që atëherë India dhe Pakistani i kanë shtuar katërfish forcat e tyre nukleare, të cilat janë në gjendje alarmi si rezultat i masakrës së Bombeit në fillim të këtij muaji.

Frika se India mund të sulmonte Pakistanin si hakmarrje për masakrën e Bombeit ka provokuar një alarm të madh këtu në Uashington. Po ashtu edhe mundësia që Pakistani të tërheqë forcat e saja, që përkrahin luftën amerikane në Afganistan dhe t'i rirreshtojë ato për t'u përballuar me Indinë. Sipas burimeve të afërta me Pentagonin, në fakt India ishte shumë afër asaj, që të ndërmernte operacione ushtarake hakmarrëse kundër Pakistanit në javën e dytë të dhjetorit.

Uashingtoni e shtyu shumë shpejt Pakistanin, që të arrestonte liderët e grupit militant **Lashkar-e-Tajiba**, të cilat India i akuzon për sulmin. Fatmirësisht vetëpërmbytja e Indisë dhe aksioni i

Pakistanit në shuarjen e grupeve militare të Kashmirit e ka ulur krizën ushtarake. Por këto veprime zbutëse nuk kanë bërë kurrgjë që të zgjidhin konfliktin që qëndron pas dy hasmëve të vjetër: Indisë dhe Pakistanit.

Lashkar është themeluar në fund të luftës Afgane Anti-Sovjetike, që të kanalizojë energjitë xhihadiste në një betejë të re për çlirimin e dy të tretave të Kashmirit të ndarë, që qeveriset nga ana e Indisë. Pakistani dhe India kanë kryer tri luftëra të mëdha për Kashmirin që nga viti 1947 dhe incidente të panumërta përgjatë kufirit të tyre të tensionuar prej vitesh.



Kashmiri është shteti i vetëm me shumicë myslimane. Muslimanët e Kashmirit kërkojnë pavarësi prej Indisë që nga viti 1947. Zgjedhja e preferuar është bashkimi me Pakistanin, kurse një pakicë e rëndësishme pretendon për një pavarësi totale të këtij shteti malor himalajan. Ky pozicion kundërshtohet nga të dyja palët në konflikt, Pakistani dhe India. Pakicat hindu dhe sike që përbëjnë 35-40 % nga gjithsej 11 milionë banorë të Kashmirit, dëshirojnë të mbeten pjesë e Unionit Indian.

Në vitin 1989 nisi një kryengritje anti-Indiane. 22 grupe xhihadiste muslimane të Kashmirit, disa prej tyre të ndihmuara fshehtas nga Pakistani luftuan kundër 50,000 trupave ushtarake dhe policore të Indisë në një luftë të fëlliqur dhe brutale, me akte egërsie nga të dy anët. Në këto zhvillime vdiqën 40,000 deri më 80,000 kashmiras, shumica prej tyre muslimanë. Grupet indiane për të drejtat e njeriut kanë kritikuar në vazhdimësi taktikat represive të Indisë në Kashmir. Këto taktika që përmbajnë në vetvete edhe dënime kolektive, helmime, likuidime dhe përdhunime të grave muslimane.

Unë kam vizituar shumë nga kampet guerile të muxhahidinëve kashmiras në një të tretën e Kashmirit të kontrolluar nga Pakistani, që gjenden afër qytetit Muzaferabad dhe i kam shoqëruar muxhahidinët kashmiras kundër forcave indiane, sikurse kam treguar në librin tim “Lufta në majë të botës”, i cili në tërësi flet për Afganistanin dhe për konfliktin e vjetër 61-vjeçar mes Indisë dhe Pakistanit për Kashmirin.

Dy grupe xhihadiste; **Lashkari** dhe **Xhejshi Muhammed**, udhëheqin kampet më të mëdha. Të dyja këto grupe kanë qenë të armatosura dhe të financuara deri në vitin 2002 nga **ISI**, Shërbimi Pakistani i Inteligjencës, i cili i shfrytëzoi këto si masha

“Washingtoni ka marrë me qira 130,000 ushtarë pakistanezë për të luftuar kundër pjesëtarëve të fiseve pash-tunë, aleatë të talebanëve në kufirin veri-perëndimor të Pakistanit...”

në Kashmir dhe si mundësi për të mbajtur jashtë ekuilibrit Indinë dhe për ta vënë atë në pozita mbrojtëse.

India dhe SHBA-të e akuzuan shpejt e shpejt Lashkarin dhe grupet e tjera xhihadiste për ndodhitë në Bombai. Delhi akuzoi Pakistanin dhe ISI-n, se janë ata që qëndrojnë pas sulmeve vrasëse, por ende ka nevojë për të sjellë dëshmi që të binden njerëzit që nuk kanë qasje në këto çështje. India i ka bërë rutinë akuzat ndaj ISI-t për incidentet e dhunshme. Në këmbim Pakistani e akuzon gjithmonë Indinë për dhunën në kufirin e vet veri-perëndimor dhe në Karaçi.

Washingtoni po ashtu pretendoi se aleati i saj i vjetër, ish-drejtuesi i ISI-t **Hamid Guli** ishte i përzier në këtë punë. Gjeneral Guli ishte i njohur për mua, që nga koha e xhihadit afgan anti-sovjetik. Guli është patriot pakistanez, jo terrorist. Krimi i tij në sytë e SHBA-ve është se i emërton Talebanët si luftëtarë të lirisë, si dhe për qëndrimin se ai akuzon SHBA-të për sulmet e 11 shtatorit. Një qëndrim ky që e përkrahin 30% e amerikanëve.

Pakistani ra nën presionin amerikan dhe burgosi liderët e Lashkarit. Pakistani tanimë ka falimentuar. Rezervat monetare të këtij shteti janë vjedhur përgjatë kohës së

diktaturës së Musharafit. Pakistani tani varet totalisht prej të hollave amerikane, një përfundim poshtërues për një komb, i cili ishte shembull i qeverisjes së mirë, drejtësisë dhe virtytit islam.

Shumica e pakistanezëve mbështesin betejën çlirimtare të Kashmirit si kauzë kombëtare të Pakistanit dhe brengën më të madhe strategjike të saj. Por pas 11 shtatorit, SHBA-të ia vunë revolen në kokë Pakistanit, duke e detyruar Musharafin që: edhe të përkrahë luftën amerikane në Afganistan, edhe të denoncojë aleatët e Pakistanit talebanët, si edhe xhihadistët e Kashmirit si terroristë.

SHBA dhe India mbetën të kënaqura. India gjithmonë e kishte pretenduar se kryengritja kashmiriane ishte terrorizëm jashtë kufirit nga Pakistani, edhe pse revolta ishte kryengritje kombëtare kundër keqqeverisjes së Indisë.

Pakistanezët u ndjenë të ofenduar nga kjo tradhti e dyfishtë dhe e thërrasin Musharafin një kukull amerikane. Tani qeveria e re e Asif Zardarit është duke vijuar të njëjtën politikë nën presion e SHBA-së, përkundër mllefrit dhe mos-aprovimit të shumë pakistanezëve. Ajo tanimë shihet si një qeverisje edhe më servile ndaj Uashingtonit, se sa paraardhësi i urryer i tij Pervez Musharafi.

Pakistani ka dy qeveri; një civile dhe një ushtarake. Gjeneralët dhe ISI asnjëherë nuk kanë hequr dorë nga qëllimi i tyre për një Afganistan të dominuar nga Pakistani dhe për vazhdimin e xhihadit për Kashmirin. Të dy këto veprime shihen si me interes jetik kombëtar. Gjeneralët pakistanezë e shohin me përçmim Zardarin, i cili po këmbëngul në korrupsionin trashanik dhe punë të paligjshme.

Uashingtoni ka marrë me qira 130,000 ushtarë pakistanezë për të luftuar kundër pjesëtarëve të fiseve pashtunë, aleatë të

talebanëve në kufirin veri-perëndimor të Pakistanit. SHBA-të u japin rrogat atyre dhe i furnizojnë me transporte dhe ushqim. Këta ushtarë të marrë me qira ose “sepojët” siç quhen ushtarët lokalë nga ana e raxhave britanikë, nuk e kanë për zemër këtë mision. Dikur ushtria pakistaneze ishte krenare, tani është kthyer në një forcë mercenare.

Tani si përgjigje për përkeqësimin e situatës ushtarake në Afganistan, Pentagoni është duke përgatitur planin për të dërguar sa më shumë divizione pakistaneze të marra me qira për të luftuar talebanët dhe forcat e tjera të rezistencës në Afganistan. Vetëm disa amerikanë e kuptojnë radikalizmin në rritje të Pakistanit, i cili po shkaktohet nga ajo se Uashingtoni po i shtyn qeveritarët dhe ushtarët e këtij vendi të shkojnë kundër ndjenjave dhe interesave të tyre kombëtare.

Përkundër kësaj SHBA-të vazhdojnë të dëgjojnë elitën e perëndimuar të Pakistanit, që përbën më pak se 1% të popullatës dhe ekspertët me tendencë majtiste, si Ahmed Rashidi, të cilët vazhdojnë t'i tregojnë Uashingtonit atë që ai dëshiron të dëgjojë e jo të vërtetat e mëdha.

Konflikti i vazhdueshëm për Kashmirin, i cili po i mban Indinë dhe Pakistanin nuklear kundër njëri-tjetrit qëndron pas masakrës së Bombeit. Zgjidhja e kësaj çështje të rrezikshme duhet të jetë prioritet i Fuqive të Mëdha, po aq sa është prioritet përfundimi i sulmeve vrasëse ndaj civilëve.

Përsëritja pa ndalim e mantras për “luftë ndaj terrorizmit” nuk do zgjidhë konfliktet e rrezikshme në Azinë e Jugut ose në Lindjen e Mesme. ■

nga anglishtja: Ramadan Ramadani

TENDENCAT GLOBALIZUESE PANEVROPIANE DHE LOGJIKA E PUSHTETIT



Pa e ditur se kush jemi, ku kemi gabuar dhe se çfarë po bëjmë, nuk mund të projektojmë një të ardhme, ku shqiptarët do të kenë vendin e tyre. Nacionalizmi romantik dhe tendencat globalizuese të pushtetit në ideologjitë e sotme bashkëkohore.

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

Logjika perandorake e pushtetit është logjika më e thjeshtë e ushtruar që në fillimet e organizimeve më të thjeshta shtetërore të njerëzimit. Kjo logjikë nuk ka të bëjë me ideologjitë e ndryshme mbizotëruese të kohëve të ndryshme. Ajo ka

të bëjë kryesisht me ushtrimin e pushtetit nga lart poshtë dhe anasjelltas dhe marrëdhëniet e varësisë dhe të vasalitetit, por që kahja kryesore është nga lart-poshtë. Tashmë sistemi perandorak apo siç mund të njihet rëndom nga njerëzit ai monarkik, nuk është më mbizotëruesi. Fundi i mbizotërimit të sistemit monarkik të pushtetit është ndërmjet dy luftërave të

“... Ishte pikërisht ideologjia nacionaliste ajo që e shthuri Perandorinë Osmane, e cila u ndihmua edhe nga Perëndimi dhe etja për reforma e shtetarëve të këtij formacioni të stërmadh perandorak...”

mëdha botërore dhe mbarimit të tyre. Kështu në Ballkan fundi i këtij sistemi daton me ardhjen në fuqi të komunistëve në pushtet pas Luftës së Dytë Botërore, kur dihet fare mirë që ideologjia komuniste aplikon formën republikane të regjimit të pushtetit, pra, formën jo të trashëgueshme. Ndërkaq proceset degraduese ideologjike shkuan në favor të platformave nacionaliste, ku fryma shoviniste e mbizotëroi arenën e politikës evropiane dhe botërore. Ishte pikërisht ideologjia nacionaliste ajo që e shthuri Perandorinë Osmane, e cila u ndihmua edhe nga Perëndimi dhe etja për reforma e shtetarëve të këtij formacioni të stërmadh perandorak. Për të mbuluar thelbin e vërtetë të ndryshimeve reformatore u përdor teoria e Osmanëve të Rinj, e cila në vetvete ngërthente ideologjinë nacionaliste të huazuar nga Evropa e përparuar, por e veshur me një qyrk ndërnacionalit apo ndëretnik. Më pas do të kemi daljen në skenë të Turqve të Rinj, të cilët ishin të pajisur dallueshëm me ide nacionaliste, por brenda një perandorie multietnike dhe multifetare. Dështimi i tyre nuk do të ishte vetëm në aspektin ideologjik, por edhe në atë politik dhe administrativ e ekonomik nga ku e kishin futur perandorinë një seri

sulltanësh të dobët. Ndërkaq edhe nga pikëpamja kohore perandoritë tashmë e kishin mbyllur ciklin e tyre historik dhe fundi i Luftës së Parë Botërore solli edhe fundin e pashmangshëm të tyre, si dhe mbizotërimin e shteteve nacionale. Në këtë prizëm arena politike botërore u copëzua ndjeshëm, sa që edhe sot e kësaj dite shumë kombe po i vuajnë pasojat e kësaj ideologjie dhe politike së bashku. Praktikisht dominimi i kësaj ideologjie dhe politike solli edhe Luftën e Dytë Botërore dhe u pa se këto ideologji në kuadrin e një dominimi botëror nuk kishin të bënin aspak me këtë realitet nacionalist, madje përbënin një pengesë tepër serioze, e cila u vu re me krijimin e dy formacioneve më të mëdha politiko-ideologjike: Bllokut Lindor dhe Bllokut Perëndimor. Shumë shpejt u vu re se shtetet nacionale me politikën e tyre krijojnë pengesa dhe ruanin meritë e vjetra. Pengesat kishin të bënin me lëvizjen e njerëzve dhe të mallrave, pra, pengesat ishin vizat e kalimit të kufirit dhe kontrollet doganore, ndërsa meritë e vjetra ekzistonin brenda të dy blloqeve dhe nuk mund t'i fshinin kollaj ideologjitë komuniste dhe ato nacionale, pavarësisht se kishin dalë në skenë dy ideologji me elemente përbashkuese, ajo e kozmopolitizmit në njërin anë dhe e internacionalizmit proletar në anën tjetër. Kështu presidenti gjermano-perëndimor **Adenauer** dhe ai francez **De Gol** arritën më në fund pas kaq vjetësh urrejtje të theksuar nacionaliste të zgjidhin mosmarrëveshjet e tyre me firmosjen e një marrëveshjeje, që do t'i jepte fund kufijve nacionalë të mosmarrëveshjeve (**Alzasa** dhe **Lorena**). Po ashtu pasuan një seri marrëveshjes që kishin të bënin me ngritjen e një Tregu të Përbashkët Evropian, e cila do të zhdukte pak nga pak kufijtë ekonomikë nacionalë. Nga ana tjetër meritë e vjetra ruse-polake apo ruse-rumune u

shuan nga ideologjia komuniste e internacionalizmit proletar dhe e sovjetizimit të pushtetit, por që në thelb ruante logjikën perandorake të pushtetit, ashtu siç po ndodhte në krahun tjetër, atë perëndimor. Marrëveshjet politiko-ushtarake të të dy Blloqeve (NATO dhe Traktati i Varshavës) u pasuan kështu edhe nga krijimi i marrëveshjeve ekonomike ndërnacionale të brendshme, si dhe krijimin e tregjeve me influenca të theksuara po ashtu politiko-ideologjike, Tregu i Përbashkët Evropian nga njëra anë dhe KNER-i nga ana tjetër. Mirëpo dështimi i Bllokut Lindor do të ishte i pashmangshëm edhe për shkak të ideologjisë me të cilën ai kërkonte të përfaqësohej dhe fundi do të vinte pikërisht kur ky bllok desh të reformohej, ndërkaq vetëm kjo ideologji nuk ka se si ta pranojë reformën. Ndërsa vendet e Tregut të Përbashkët kanë kaluar në një shkallë tjetër organizimi, në atë politike, duke u përpjekur kështu për një organizëm të ri politik mbinacional, Bashkimin Evropian. Ky proces nuk e ka arritur kulmin e saj, por tashmë një pjesë e mirë e kufijve politikë kanë rënë në kuptimin e lëvizjes së lirë njerëzore dhe për pasojë edhe të mallrave, duke krijuar kështu një zgjerim të tregjeve dhe formimin e tregjeve të rinj rajonalë. Pra, integrimi i tregjeve dhe lëvizja e lirë sot janë kryefjala e kohës, të cilën ne të gjithë duhet ta kemi parasysh, nëse me të vërtetë duam që të mbijetojmë. Suksesi qëndron në proceset integruese tregtare e politike dhe jo vetëm pse jemi shqiptarë, për më tepër si të tillë nuk kemi se çfarë të eksportojmë. ■

SHQIPËRI: ALLAHU I NDALUAR?!

Shënim i redaksisë: Shkrimi i mëposhtëm është një reportazhë për Shqipërinë që ka sjellë në TV5 Monde të Francës, kryeredaktori i këtij televizioni Slimane Zeghidour. Njeriu që përveç angazhimit në gazetari është një prej studiuesve më të spikatur në Francë për çështjet rreth muslimanëve dhe është edhe ligjërues në fakultetet Sciences Politiques në Menton dhe Poitiers. Titulli i shkrimit në original është : « Albanie, Allah banni? » (Shqipëri: Allahu i ndaluar?). ndonëse ky shkrim u botua edhe në disa të përditshme në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, redaksia jonë zgjodhi ta ribotojë këtë shkrim edhe në revistën tonë dhe tuajën Albislam, si dëshmi për atë se në botë nuk shihen me sy të mirë shumë prej marrive që ndodhin në viset tona.

SLIMANE ZEGHIDOUR

Kur mbërrin në Tiranë, kryeqytetin e Shqipërisë, pret të zbresësh në një shkretëtirë shpirtërore post-komuniste. A nuk mburrej vallë regjimi grotesk leninistomaist i Enver Hoxhës se kish farkëtuar me hekur e zjarr “shtetin e parë ateist të planetit”?

Gabim. Aeroporti është ripagëzuar... Nënë Tereza, dhe padyshim mund të mburret se është i vetmi aeroport në botë, që mban emrin e një shenjtoreje, e cila për më tepër është edhe laureate e çmimit Nobel. Ah, kjo Shqipëria e pabesueshme, ku vetëm njëzet vjet



më parë, varja e kryqit apo shfletimi i Kuranit mjaftonin për të të damkosur si “armik populli”, domethënë i partisë, më saktë i Shefit të gjithëpushtetshëm.

Shefi shkoi, vdiq më 1985... Që prej kësaj kohe, Zoti zuri sërish vend. Gjithë vendin? Kjo pyetje shtrohet sapo del nga aeroporti kur përballësh hundë më hundë me shtatoren e Nënë Terezës.

Ja pra, një vend ateist në të cilin tashmë gjithçka sillet rreth emrit të Zotit. “Vendi betohet, bile deri në tradhti, thotë Ilir Yzeiri, edhe pse besimi është shkërmoqur prej një gjysmë shekulli shpëlarje trush intensive”. S’ka pra asgjë për t’u habitur, për këtë historian dhe gazetar frankofon, me skuadronet e priftërinjve, popëve, imamëve, pastorëve të gjithë llojeve, guruve e shitësve ambulantë të shpirtrave, amerikanë, kroatë, grekë, turq, arabë, spanjollë, iranianë... që me vrik investuan në Shqipëri, në ish-shkretëtirën fetare tashmë shndërruar në “tokë misioni”.

Ja pra, sidomos, një tokë islame, ku në

dhjetë banorë shtatë janë muslimanë, dy ortodoksë dhe një katolik, por ku – dhe këtu qëndron e papritura – mbijnë më shumë kambana se minare. Më mirë akoma, shteti ka lartësuar në festë kombëtare 19 Tetorin, për nder të asaj dite të vitit 2003, kur Nënë Tereza u lumnuar nga Gjon Pali II, në Romë.

Në kryeqytet, Tiranë, Islami ka profil të ulët. Nga zemra e këtij qyteti të këndshëm, ngrehur që prej vitit 1614 prej gjeneralit osman Sulejman Pasha, ka mundur t’i shpëtojë uraganit maoist vetëm një monument – tashmë ndër të vetmit më antikë të qytetit: xhamia e Et’hem Beut. Ndërtuar ndërmjet viteve 1792 dhe 1821, ky tempull islam i tëhuajësuar për gati gjysmë shekulli, iu hap besimtarëve vetëm në vitin ... 1991, teksa një turmë prej 10 000 besimtarësh mësynë të faleshin më në fund në dritën e diellit.

Xhamia, e cila prezantohet si “monument historik” në faqen e internetit të kryeqytetit, qëndron jo larg statujës së

ashpër kalorësiake të heroit kombëtar, Skënderbeut (1405-1468), këtij katoliku shqiptar, i cili pasi përqafoi Islamin e shërbeu pranë sulltanit osman, u rikthye në katolik dhe i dha jetë një lufte të fortë, por të pafrytshme kundër “të pabesit turk”. Shqipëria e ringjalli kujtesën për të, që prej fillimeve të shekullit XIX dhe e lartësoi si atin e Kombit përpallë Të Përvjetshmit. Xhamia mund të presë vetëm një grup të vogël besimtarësh nën arkadat e stolisura me ndërthurje, korniza të peizazheve të pazakontë fshattrash toskanë. Sot mund të takosh rëndom besimtarë të moçëm ose – shenjë e kohës? – shumë të rinj. Këtu, nuk ka predikime, vetëm një thirrje *a capella* e muezinit, e cila thithet e humbet shpejt në zallamahinë e qytetit.

Besimi i Muhamedit na qenka atëherë kushëriri i varfër i Shqipërisë “demokratike”? “Islami është besimi i të përjashtuarve”, thekson **Ervin Hatibi**. Poet i njohur, artist figurativ dhe intelektual i respektuar, vëren në establishmentin shqiptar një refuzim alergjik dhe “nevrotik” të prurjeve osmane dhe islame në identitetin shqiptar. Në fillimet e shekullit XX, kujton ai, Tirana dispononte 19 xhami për vetëm 20,000 shpirtra; sot, numërohen vetëm 6 faltore për një milion banorë.

Teksa përshkon poshtë e përpjetë Tiranën, asgjë, ose shumë pak të përkujton se ndodhesh në kryeqytetin e një vendi musliman, i cili i dhuroi Perandorisë Osmane një pafundësi kryeministrash, ulemash, gjeneralësh... dhe Orientit arab një dinasti e cila, prej *kedivit* Mehmet Ali e deri tek mbreti Faruk, hodhi bazat e Egjiptit modern. Nuk ratis të hasësh vajza të mbuluara – me përjashtime shumë të rralla – apo imamë me turbanë apo restorante që shpallen “hallall”.

“...Mohimi i trashëgimisë islame ushqehet nëpërmjet adhurimit të “rrënjëve të krishtera”... si dhe vlerësimit të një ligjërimi në lavdi të një dege të sufizmit...”

Ndërkaq kurrfarë modestie për gjithë çka evokon “rrënjët e krishtera të Shqipërisë”, thënie e Sali Berishës, kryeministrit aktual, “musliman” edhe ky. Përveç sheshit Nënë Tereza, bulevardit Gjon Pali II, pa përmendur rrugën... George W. Bush, na dëftohet e esëllt dhe e bujshme, katedralja katolike e Shën Palit ndërtuar pikërisht në vendin e treguar nga Nënë Tereza më 2002, vend i cili i ish “përcaktuar nga Virgjëresha”. Kjo për sa i përket katolikëve. Ndërsa ortodoksët po përfundojnë së ndërtuari në qendër të qytetit një mega-kishë me trajtat e një stacioni kozmik. Dhe kudo, basorelieve, shtatore, buste, afishe, mbajtëse çelësash, stilolapsa, stema... me shëmbëlltyrën e Nënë Terezës, ikona e re kombëtare, me rruzare apo Bibël në dorë.

Mohimi i trashëgimisë islame ushqehet nëpërmjet adhurimit të “rrënjëve të krishtera”... si dhe vlerësimit të një ligjërimi në lavdi të një dege të sufizmit, e cila nis në shekullin XIII prej një mistiku turko-irani, Haxhi Bektash Veliut (1209-1271). Kjo ligjëratë e zyrtarizuar e shpall kultin bektashi, si “një fe nyje lidhëse” ndërmjet Kryqit dhe Gjysmëhënës, fryt i natyrshëm i “gjenialitetit shqiptar” jo më pak të natyrshëm, tolerant sepse në fakt është shumë pak fetar. Njëherësh të

krishterë dhe muslimanë, pak fare paganë, pirës alkooli dhe amatorë shishqebapësh derr safi, besimtarët bektashinj paskërkan vetëm një lidhje sa simbolike, po aq edhe të përkohshme me Islamin.

Vizitë tek Haxhi Dede Reshat Bardhi, kryegjyshi bektashi, në selinë qendrore një ndërtesë kjo e bollshme, dikur e sekuestruar nga shteti ateist. Dy shtatore të mëdha në allçi, njëra, përfaqëson Hysenin, nipin e Muhamedit, martirizimi i të cilit ushqen besimin shiit; tjetra, Haxhi Bektashin, presin e përcjellin vizitorin. Lëng kajsie, dy çokollata të mbushura dhe pas pak vjen shehu, që ulet në një kolltuk nën një afresk që përfaqëson Aliun, dhëndrin e Profetit dhe atin e Hysenit, Haxhi Bektashin, pranë një luani dhe mbi ta engjëj të lumturuar.

Kostumi jeshile e thellë, syri blu i flaktë dhe mjekra borë e bardhë i japin të zotit të këtij vendi tiparet e një mbreti mag dalë nga një libër përrallash me vizatime. A konsiderohen bektashinjtë si muslimanë? “Si jo!”, hidhet ai, -patjetër, me njëmijë për qind”. I ngacmuar nga pyetja, ai vazhdon: “E dini që kam qenë i persekutuar si armik populli; kurrë nuk e kam mohuar fenë time”. Hani mish derri? “Po talleni, ma kthen ai duke i rënë këmbës, unë kam bërë haxhin në Mekë!”...

Përse atëherë ky ligjërim i përhapur mbi Bektashizmin mohon gjithçka muslimane tek ai? Në këtë zhvlerësim të traditës islame, Ervin Hatibi nuk sheh urrejtje fetare, por padyshim një llogari oportuniste, sipas së cilës nuk paskërka tjetër rrugë më të shkurtër për të merituar favorët e “Perëndimit” – i paragjykuar si i krishterë dhe islamofob – sesa të mohosh Islamin.

Ky mohim i habitshëm, flagrant i historisë ushqen një debat të pareshtur në Shqipëri, ndërkaq ai përbën edhe objekt studimesh të gjera akademike. “Të duash të zhdukësh trashëgiminë osmane, e cila në të mirë a në të keq, ka formësuar identitetin e sotëm të popullit shqiptar, do të thotë ta privosh atë nga kultura dhe identiteti i tij”, vëren kërkuesi francez, Jean Arnault Dérens.

Po Evropa vetë, si e pranon ajo zellin shqiptar për t’u pranuar në “klubin e krishterë”? Ajo irritohet në emër të principit supra të shenjtë të laicitetit dhe nuk heziton ta bëjë këtë të ditur, me sa duket. Kësisoj, nëse i besojmë një funksionari të lartë, i cili dëshiron të ruajë anonimitetin, autoritetet shqiptare i paskërkan propozuar Komisionit Evropian një projekt pasaporte të ilustruar prej dy figurave më se katolike: Nënë Terezës dhe patjetër, Skënderbeut, i mbiquajtur “atleti i Krishtit” – titull ky i trashëguar më vonë prej Gjon Palit II – i cili ka luftuar me osmanët. Brukseli thjesht e paskësh përcjellë Tiranën duke iu kundërvënë me një përgjigje të qartë për mospranimin të një projekti të gjykuar si bezdisje e panevojshme për të paktën dy të tretat e shqiptarëve. Vetë Nënë Tereza nuk do të ish pikëlluar për këtë refuzim. Gjatë ceremonisë së marrjes së çmimit Nobel ajo do të deklaronte: “Me gjak jam shqiptare. Me shtetësi jam indiane. Me besim jam fetare katolike. Për sa i përket thirrjes sime i përkas gjithë botës. Për sa i përket zemrës sime, i përkas e gjitha Zemrës së Krishtit.” ■

DHUNIMI I GRAVE — LIGJI ISLAM

Shumëkush mundohet të flasë për Islamin dhe sheriatin, duke u treguar para një opinioni kinse ka lexuar shumë për këtë Fe dhe gjatë shkrimeve të tyre i përdorin tre-katër terme që ndoshta lexuesi i rëndomtë s'ka dëgjuar për to dhe sulen të tregojnë sesa i padrejtë dhe i prapambetur na qenka Islami. Këtu po ju sjellim një shkrim se çfarë flitet në mediet perëndimore për ligjin Islam që ka të bëjë me dhunimin e grave dhe menjëherë pas tij një shkrim që demanton të pavërtetat e shkrimit të parë.

SË PARI: ÇFARË THONË MEDIET PERËNDIMORE?

**Nga Barbara Plett
BBC News, Islamabad
SI KANË NGECUR REFORMAT PAKISTANEZE
RRETH DHUNIMIT?**

Qeveria Pakistaneze e ka pezulluar projektligjin kontradiktor mbi të drejtat e grave, duke shkaktuar kështu trazira në përpjekje për të reformuar ligjet islame rreth dhunimit

Partitë shekullare u tërbuan pas amendamenteve që pësoi draft-ligji për t'i kënaqur partitë ultra-konservatore të Pakistanit. Tani autoritetet janë duke bërë përpjekje të ashpra për të arritur në një konsensus, para se të provojnë që për herë të katërt ta paraqesin projektligjin në parlament. Kjo gjendje që po mbretëron



është cilësuar nga ana e aktivistëve për të drejtat e njeriut, si një tragjedi për femrat pakistaneze. Kjo po ashtu shihet si edhe një dëshmi që tregon se qeveria e gjeneralit Pervez Musharaf mbetet e varur nga islamistët, sado që ai pohon se është duke promovuar Islamin e 'moderuar dhe të arsimuar'.

“Në Pakistan në çdo dy orë dhunohet nga një grua dhe çdo tetë orë dhunohet nga një grup meshkujsh. Këto shifra janë ndoshta të nënvlerësuara meqë shumë raste dhunimesh mbesin të pa-raportuara.”

Dhunimet e pa-raportuara

Në Pakistan, dhunimet trajtohen sipas ligjeve islame të njohura si **hudud**. Këto i kriminalizojnë të gjitha aktet seksuale jashtëmartesore. Prandaj sipas hududit, nëse viktimi e dhunimit nuk arrin t'i siguroj katër meshkuj dëshmitarë të krimit, atëherë vetë viktimi mund të ballafaqohet me dënimin. Kjo mënyrë e ka bërë pothuajse të pamundur ndjekjen penale të dhunimeve. Sipas komisionit vendas të pavarur për të drejtat e njeriut, në Pakistan në çdo dy orë dhunohet nga një grua dhe çdo tetë orë dhunohet nga një grup meshkujsh. Këto shifra janë ndoshta të nënvlerësuara meqë shumë raste dhunimesh mbesin të pa-raportuara.

Paniku i qeverisë

Gjersa u shemb partia e tij politike në pushtet, presidenti Musharaf dukej se ishte i vendosur t'i reformojë dispozitat islame (hudud). Pavarësisht nga vërejtjet e zhurmshme që vinin prej partive islame-aleanca e njohur si **Muttahida Mexhlis-e-Amel** (MMA), projektligji u miratua nga komiteti parlamentar me ndihmën e partisë kryesore shekullare në opozitë, Partia Popullore e Pakistanit (PPP). Ky komitet propozoi që dhunimet të largohen

nga ligjet fetare dhe në vend të kësaj të vendosen në kodin penal shekullar, ku do të merreshin parasysh dëshmitë e zakonshme. MMA-ja e kundërshtoi një propozim të tillë duke kërcënuar se do të jepnin dorëheqje kolektive nëse një projektligji i tillë do të miratohej. Të zënë në panik, qeveria themeloi një komitet të posaçëm parlamentar të dijetarëve fetarë, në mënyrë që të qetësojë islamistët. Ky veprim theksonte se rastet e dhunimit duhet të trajtoheshin sipas ligjeve islame dhe atyre shekullare, duke futur kështu një kategori të re dhe me një përkufizim më të gjerë të 'paturpësisë' në kodin penal, njëkohësisht edhe rivendosjen e klauzolës, e cila i jep përparësi **Hududit** ndaj çdo ligji tjetër me të cilin mund të bie ndesh.

Izolimi politik

Partitë politike liberale, aktivistë të të drejtave civile dhe njerëzore dhe avokatët kanë theksuar se këto ndryshime në thelb heqin kuptimin thelbësor të reformës, duke i mundësuar kështu lobeve të ndryshme fetare të manipulojnë me sistemin juridik që shihet si i dobët. Ata po ashtu kanë denoncuar qeverinë për shmangie të procedurave parlamentare. Gjenerali Musharaf duhet të ketë qenë në dijeni, se çdo ndryshim i hududit do t'i zemëronte islamistët. Atëherë pse qeveria e tij u gjuhëzua aq shpejt pranë tyre? Komentuesit i japin dy arsye. E para është se partia në pushtet është e ndarë mes atyre anëtarëve që dëshirojnë të ruajnë aleancën me MMA, ndonëse këtë nuk e shprehin me fjalë, dhe atyre që mundohen ta çojnë përpara procesin e reformës në aleancë me PPP-në, e cila udhëhiqet nga ish-kryeministrja **Benazir Bhuto**. Arsyeja e dytë është se rrallëherë ka ndodhur që Presidenti Musharaf dhe regjimi i tij ushtarak të jenë aq të izoluar. Tani këta

ndodhen para kundërshtimeve që vijnë goftë prej shekullarëve, partive nacionale apo islamistëve, të cilët kërcënojnë me protesta në rrugë.

Aleanca e paprekshme

Presidenti është kritikuar ashpër nga vendasit për shkak të përdorimit të tepruar të forcës kundër rebelëve nacionalistë në provincën e tensionuar të Beluçistanit dhe jashtë shtetit për shkak të marrëveshjes paqësore me fisin protaleban në territorin fisnor të Veziristanit verior. I sulmuar nga të gjitha anët, e vetmja mbështetje e Presidentit mbetet ushtria, e cila nuk është e gatshme të ballafaqohet me islamistët rreth të drejtave të grave. Kështu që pas një jave dredhish parlamentare dhe jashtëparlamentare, aleanca ushtarake dhe mullahët, që janë duke qeverisur Pakistanin në shtatë vitet e fundit duket e tronditur, por e paprekshme.

Gratë kanë mbetur në mëshirën e legjislacionit të fundamentalistëve. Ndërsa mesazhi i gjeneralit Musharaf për 'moderim dhe arsimim' duket të jetë më tepër për konsum të huaj sesa për vendasit.

Marrë nga:

http://news.bbc.co.uk/2/hi/south_asia/5346968.stm

SË DYTI: ÇFARË ËSHTË E VËRTETA ISLAME?

**Përpiluar nga Komiteti Kërkimor i islamtoday.net nën mbikëqyrjen e Shejh ABDULUEHAB TUREJRIT
DHUNIMI NUK NGELET I PADËNUAR NË MUNGESË TË KATËR DËSHMITARËVE**

Ekzistojnë shumë keqkuptime rreth asaj se si gjykohet nën Juridiksionin Islam dhunimi. Shumë njerëz kanë krijuar

opinionin e gabuar, se duhet patjetër që katër dëshmitarë ta shohin aktin e dhunimit në mënyrë që gjykatat ta shpallin dënimin. Njëkohësisht këta njerëz, që është shumë e kuptueshme tmerrohen me faktin se gruaja, e cila nuk arrin t'i sigurojë katër dëshmitarë të kimit nuk do të jetë në gjendje ta çojë para drejtësisë përdhunuesin. Mirëpo kjo është larg së vërtetës.

Është e vërtetë se dënimet e parashikuara me shariat (hudud) për kurvëri kërkojnë katër dëshmitarë në mënyrë që të zbatohet dënimi specifik e që nënkupton detyrën e shenjtë, që kryejnë gjykatat muslimane. Kjo lë të kuptohet se në mungesë të katër dëshmitarëve, gjykatësi vendos për dënimin e autorit të kimit sipas bindjes së tij të lirë apo sipas kodit penal të atij vendi. Ai nuk detyrohet të sjellë dënimin e paraparë në Shariat për kurvërinë. Në çfarëdo rasti dhunimi konsiderohet vepër më e rëndë se kurvëria, dhe si rrjedhojë meriton dënim më të rëndë.

Këtu duhet të sqarojmë një keqkuptim shumë të përhapur ndër njerëz rreth sistemit juridik në një shtet që funksionon me parametrat e ligjit islam. Shpeshherë supozohet se çdo vendim dhe çdo dënim që jepet në vendet Islame buron drejtpërdrejtë nga mësimet e fesë Islame dhe ligjet e shenjta. Mirëpo kjo nuk është aspak e vërtetë.

Gjykata që funksionon sipas ligjit Islam detyrohet t'i zbatojë urdhrat ligjore Islame në ato instanca ku urdhrat janë relevantë. Në rast të kundërt vendimet juridike të gjykatës do të bazohen në aplikimin dhe interpretimin e së drejtës statusore të shtetit përkatës dhe në bindjen e lirë të gjykatësit, siç ndodh edhe në sistemet juridike shekullare.

Në Islam vetëm një numër i vogël

“Shumë njerëz kanë krijuar opinionin e gabuar, se duhet patjetër që katër dëshmitarë ta shohin aktin e dhunimit në mënyrë që gjykatat ta shpallin dënimin...”

krimesh që përmenden në tekstet e shenjta gjykohen me dënime të parashikuara me Sheriat (hudud). Po këto tekste përcaktojnë dëshmitë e detyruara në mënyrë që të provohet fajësia. Kur këto dëshmi vërtetohen, atëherë bëhet detyrë fetare për gjykatat që ta zbatojnë ndëshkimin. Janë të pakta krimet e këtyre llojeve. Madje edhe nëse dëshmitë e detyruara nuk mblidhen për t'u realizuar ndëshkimi i paraparë me Sheriat për krimet e lartpërmendura, atëherë gjykatat nuk detyrohen ta zbatojnë këtë dënim, kjo çështje kalon tek gjykimi i lirë i gjykatës. Kjo bëhet, sikurse edhe krimet tjera, çështje për të cilën vendos gjykata me vetë autoritetin e saj apo shteti sipas sistemit legal të tij nëpërmjet legjislacionit statusor. Dënimi i bazuar në bindjen e lirë (ta'ëzir në gjuhën arabe) mund të jetë burgim i zgjatur, madje edhe dënim me vdekje. Si shembull për këtë po marrim ligjin, të cilin e kanë miratuar dijetarët në Arabinë Saudite, ku dënimi me vdekje është i dekretuar për kontrabanduesit e drogës, të cilët transportojnë sasi të mëdha të saj. As në Kuran, as në Sunet nuk përmendet një dënim i tillë. Ky është një dënim i bazuar në gjykim të lirë që përcaktohet nga statuti.

Gjykatat dhe kodet e të drejtave civile mund të përcaktojnë dëshmitë e

detyruara, që nevojiten për t'u ekzekutuar dënimi. Këtu mund të merren parasysh dëshmitë e varura nga rrethanat, çfarëdo numri i dëshmitarëve, qoftë meshkuj apo femra, dëshmitë e ADN-ës etj.

Për shumicën rasteve në fushën civile dhe atë penale, që shprehen vendimet në gjykata të vendeve islame, nuk sillen vendimi në bazë të mësimeve fetare. Në shumicën e rasteve penale përcaktimi i krimit bëhet në bazë të së drejtës statusore, e cila është zhvilluar përmes procesit legjislativ të vendit. Prandaj dënimi do të shqiptohet në bazë të së drejtës statusore, ose sipas bindjes së lirë të gjyqtarit. Kjo është e ngjashme me sistemin juridik të vendeve shekullare.

Gjykatat shekullare të shteteve perëndimore dhe të shteteve të tjera shekullare nuk kanë dënime të bazuara në shpalljen hyjnore. Të gjitha dënimet përcaktohen në bazë të gjykimit të lirë të gjykatave, ose në bazë të së drejtës statusore dhe asaj penale. Edhe këtu përdhunuesit dënohen për krimet e tyre. E njëjta gjë vlen edhe për gjykatat që veprojnë sipas sistemit juridik islam. Në rast të mungesës së dëshmimeve specifike që kërkohen për ta zbatuar dënimin të paraparë me sheriat, atëherë gjykata vendos sipas parimit të bindjes së lirë.

Allahu e di më së miri.

Marrë nga:

http://www.islamtoday.com/showme2.cf m?cat_idw2&sub_cat_idw1938 ■

PORTRETI I NJË UDHËTARI

Të gjithë e kujtojmë përmallimin për shtëpitë tona që na kaplon kur largohemi prej vatrave tona. Mallëngjimi për shtëpinë e tij e kaplon çdo udhëtar. I këtillë, i përmalluar për Allahun dhe xhenetin e tij është udhëtar drejt ahiretit në këtë botë. Ndihet i huaj në këtë botë kalimtare.

MUHAMED SHERIF

Fudajl b. Ijadi, Allahu e mëshiroftë, një ditë fu ul pranë një plaku dhe e pyeti: Sa vjet i ke? -Gjashtëdhjetë,- u përgjigj plaku. -A e di, -i tha Fudajli, se prej gjashtëdhjetë vitesh je duke udhëtuar drejt Zotit dhe gati sa ke mbërritur. Njeriu heshti dhe pastaj pëshpëriti: -Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi! -A e di kuptimin e kësaj që sapo the,- pyeti Fudajli. -Je duke thënë se je rob i Allahut dhe se tek Allahu do të kthehesh. Ai që e di se është rob i Allahut dhe se tek Allahu do të kthehet duhet ta dijë se në Ditën e Gjykimit do të ndalohet dhe do të merret në përgjegjësi për veprimet që i ka kryer në jetë. Ai me siguri do të pyetet, e atë që e presin këto pyetje, që tani duhet të fillojë me përgatitjen e përgjigjeve.

-Çfarë duhet të bëj, -pyeti plaku.

-Është fare e thjeshtë, vepro mirë në ato ditë që të kanë mbetur dhe Allahu do t'i falë ato që ke bërë në të kaluarën. Në të kundërtën do të përgjigjesh për të kaluarën dhe për ditët që ke para vetes.

Ditët e pleqërisë, nëse i arrijmë, nuk i kemi larg dhe përgatitja për udhëtim duhet të fillojë. Në të kaluarën, jo të largët, shkretëtirat ishin vendi më i vështirë për të udhëtuar, të gjata, të thata, vapa e papërballueshme etj. Askush nuk guxonte të merrte udhën pa ujë, pa ushqim në sasi të mjaftueshme. Pa këto harxhe të mjaftueshme udhëtimi ishte vetëm një ëndërr.

Në ajetet që flasin për haxhillëkun, gjatë

rrëfimit për udhëtimin për të arritur tek shtëpia e lashtë, Allahu na rikujton një udhëtim të një lloji tjetër. Një udhëtim në të cilin marrin pjesë të gjithë shpirtrat, ata që kujdesen si dhe të pavëmendshmit, udhëtimin drejt ahiretit, drejt parajsës ose ferrit.

Allahu, subhanehu ue teala, thotë: **“Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!”** (Bekare, 197)

Ibën Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të, tregon: Një ditë isha me të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, ai u kthye nga unë, duart e tij të bekuara i vendosi mbi supet e mia dhe më tha: *Në këtë botë sillu si i huaj ose si udhëtar.* Ibën Omeri i këshillonte nxënësit e tij: Në mbrëmje mos e pritni agimin, kurse kur të gdhini në mëngjes mos e pritni mbrëmjen. Shfrytëzoheni shëndetin para se të sëmureni, jetën para se të vdisni. Shënon Buhariu.

Tregimi im dhe i yti në këtë jetë duhet të jetë si tregimi i një të huaji në ndonjë qytet ose si i udhëtarit. Para ca kohësh shkruesi i këtyre rreshtave u largua prej qytetit të Medinës, pasi qëndroi aty gjashtë vite. Në ditët e fundit çdo gjë dukej interesante, por nuk kishte kohë që njeriu të kënaqej me to. Namazi në xhaminë e të Dërguarit tani dukej disi më madhështor, më ndikues... Erdhi koha për tu larguar. Kur prindërit tanë Ademi dhe Hava u larguan prej xhenetit zemrat e tyre vazhduan të rënkojnë duke e kujtuar me mall shtëpinë e tyre të parë. Të gjithë e kujtojmë

“Gruaja vrapoi drejt telefonit, fëmijët shikojnë djath-tas, majtas, a ka kush e shpëton babën tonë. Jo nuk ka shpëtim për atë që i ka ardhur vdekja...”

përmallimin për shtëpitë tona që na kaplon kur largohemi prej vatrave tona. Mallëngjimi për shtëpinë e tij e kaplon çdo udhëtar. I këtitillë, i përmalluar për Allahun dhe xhenetin e tij është udhëtari drejt ahiretit në këtë botë. Ndihet i huaj në këtë botë kalimtare.

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Shembulli i kësaj dynjaje është shembulli i një udhëtari, i cili duke udhëtuar në vapën e pasdrekes, u ndal të pushojë nën hijen e një druri për ca çaste, pastaj u ngrit dhe vazhdoi rrugëtimin”*. (Hadithi është hasen. E shënojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu.) Udhëtimi-jeta. Destinacioni-xheneti ose xhehenemi. Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të, shpeshherë thoshte: Dynjaja është duke u larguar dhe ahireti është duke u afruar. Edhe dynjaja i ka fëmijët e saj edhe ahireti i ka fëmijët e tij. Bëhuni prej fëmijëve të ahiretit e mos u bëni prej fëmijëve të dynjasë. Sot në dynja është koha për punë dhe nuk ka llogari. Nesër në ahiret do të llogariteni dhe nuk do të punoni.

Një i urtë në një rast tha: Për t’u habitur është halli i atij, të cilin kjo dynja dita-ditës e braktis dhe të cilit ahireti dita-ditës i afrohet. Si angazhohet me dynjanë, e cila e braktis dhe e harron ahiretin, i cili e pret krahëhapur.

Muhamed b. Vasi, Allahu e mëshiroftë, një herë u pyet se si ndihet. Përgjigja e tij ishte: Çfarë mendon për atë, i cili për çdo ditë i afrohet ahiretit.

Vëlla i dashur dhe motër e nderuar, çdo



shpirt e bën rrugëtimin e vet. Disa këtë e kanë kuptuar dhe ditët i kalojnë duke u përgatitur për përgjigjet e asaj dite në të cilën çdokush do ta merr shpërblimin e vet. Të tjerët e “jetojnë jetën e tyre” deri në skajshmëri, të shkujdesur dhe mospërfillës për ahiretin. Allahu i Lartësuar e përshkruan atë ditë kur përfundimisht njerëzit do të zgjohen dhe erën e zjarrit. *“(Mohuesit do t’i thuhet): “Ti ke qenë i pavëmendshëm për këtë. Tashti ta kemi ngritur perden (e syve), dhe shikimi yt sot është i mprehtë.”* (Kaf, 22).

Ata jetojnë në dehje satanike. Interesimi i vetëm është vetura e re, shtëpia më e madhe, pasuria... disa zgjohen në këtë botë, kur akoma ka kohë për pendim. Disa të tjerë këtë ajet do ta dëgjojnë, kur pendimi do të jetë i pavlefshëm.

Të shkujdesurit

Në kaptinën Kijame Allahu, subhanehu ue teala, e përshkruan nxjerrjen e shpirtit, ato

momente të fundit. Me sa duket është shtrirë në shtratin e gjumin, duke mos menduar se duhet të zgjohet për ta falur sabahun. Fëmijëve të tij u ka premtuar se gjatë verës së ardhshme do ta vizitojnë **Diznilendin**. Bashkëshortes i ka premtuar një fustan të ri. Vetes i ka premtuar... por gjatë natës i erdhi një vizitor, të cilin nuk e priste. Ky takim qëmoti ishte i caktuar, ti e zure për asgjë dhe e harrove.

“Por kur shpirti të vijë në grykë...” (Kijame, 26) Shpirti del prej trupit duke u drejtuar nga gryka e fytit, këmbët, duart, trupi janë pajetë. Shpirti bënte gargara në fyt. U dëgjua një britmë. Gruaja dhe fëmijët u afruan, ç’ke, ç’ke... jo përgjigje s’ka. Udhëtimi i tij tani filloi.

“e të thërrasin “A ka shërues”. (Kijame, 27) Gruaja vrapoi drejt telefonit, fëmijët shikojnë djathtas, majtas, a ka kush e shpëton babën tonë. Jo nuk ka shpëtim për atë që i ka ardhur vdekja.

“atëherë, ai (që po vdes) do të bindet se ky është çasti i ndarjes.” (Kijame, 28) është ballafaquar me realitetin. Bindet se fundi ka ardhur...

“dhe këmbët do të ngrijnë. Atë ditë, ai do të sillet te Zoti yt.” (Kijame, 29-30)

Në fund dëgjoje këtë këshillë profetike: *“Shfrytëzoji pesë gjëra para pesë të tjerave, rininë para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para kohës kur do të angazhohemi, jetën para vdekjes.”* ■

Përktheu: Talha Kurtishi

BANKAT ISLAME... SHPËTIM NGA KRIZA EKONOMIKE?

Ideja e bankave pa kamatë vazhdonte të zhvillohej në rrafshin shkencor-teorik, por edhe në rrafshin praktik. Tashmë njoh shumë të rinj myslimanë, që janë specializuar si ekonomistë në universitetet amerikane

PROF. DR. XHAFER SHEJH IDRIS

Nga rezultatet e çuditshme të krizës ekonomike, e cila filloi në Shtetet e Bashkuara dhe më pas përfundi Evropën dhe botën në përgjithësi është fakti se shumë ekonomistë dhe politikanë kthyen shikimin drejt parimeve të ekonomisë islame dhe e shohin atë si një mundësi për zëvendësimin e ekonomisë së sotshme dhe tejkalimin e problemeve që shkaktoi kjo e fundit.

Tregimi i thirrjes për të themeluar organizata bashkëkohore ekonomike në pajtim me parimet e ekonomisë islame është një tregim plot ankth, tregim që bashkoi mes thirrjes me argumente shkencore dhe shembujve praktikë, mirëpo Allahu i shënoi atij një sukses të madh. Ky tregim, siç më



kujtohet, filloi në vitet pesëdhjetë të shekullit të kaluar. Atëherë disa ekonomistë profesionistë islamë në Egjipt dhe Pakistan – ndoshta edhe në vende tjera – thërrisnin në atë që ata e quajtën **“banka pa kamatë”**. Nga më të dalluarit ishte ekonomisti pakistanez **Nexhati Sadiki**. Ata nuk thërrisnin thjesht t’i përmbahemi parimeve islame, por kishin përfituar nga përvoja e tyre në këtë fushë, që të sqarojnë se ajo është e mundshme, madje ata propozonin metodat praktike për ta realizuar atë.

E natyrshme ishte që me këta të tallen imituesit e gjithë asaj që quhet perëndimore, të cilët mendojnë se çdo organizatë perëndimore qoftë ajo politike, ekonomike, edukative etj., është detyrim i kohës dhe se çdo zëvendësim për to quhet përrallë apo diçka që e ka shkrirë koha. Mirëpo ata pionierë ishin të bindur në vërtetësinë e asaj që thoshin, prandaj vazhduan të shkruajnë për bankat pa kamatë, duke mos ia vënë veshin fjalëve të të verbërve.

Çështja përparoi saqë arriti të organizohen konferenca për ekonominë islame. Ndoshta, e para nga ato ishte konferenca që u organizua në Mekë, në vitin 1975 (1395 H) me titullin: **“Konferenca e parë për ekonominë Islame”**, në të cilin kisha nderin të jem i pranishëm.

Më pas, disa biznesmenë që u bindën nga kjo ide, bënë hapin e parë për të realizuar atë dhe banka e parë ishte: **“Banka Islame e**

Dubait”, të cilën e pasoi menjëherë: **“Banka Islame Fejsal”**. Veprimin e këtyre bankave e kundërshtuan pronarët e bankave të tjera që punonin me kamatë, madje u munduan t’i luftojnë ato. Gjithashtu këtë e kundërshtuan edhe disa të tjerë që shpreheshin se asgjë nuk mund të quhet **islame**, nëse në të ka ndonjë mangësi, kështu që filluan të zbulojnë ndonjë nga lëshimet praktike të këtyre bankave, që t’i përdorin si mjet për t’i luftuar të njëjtat. Edhe sot më kujtohet nga disa njerëz, në një seminar të hapur në Rijad, ku diskutohej çështja e bankave islame, sesi i përmendnin dijetarit Abdulaziz b. Bazit ca prej lëshimeve/mangësive të këtyre bankave, mirëpo përgjigjja e dijetarit të zgjuar ishte me këtë përmbajtje: **“Me gjithë lëshimet që kanë, ato janë më të mira sesa bankat që punojnë qartësisht me kamatë”**.

Më pas, elhamdu lillah, këto banka u shtuan dhe u përhapën në shumë vende të botës islame, pastaj edhe në të gjithë botën, sikurse në Evropë dhe Amerikë, të cilat i njohën disa ekonomistë profesionistë, por edhe njerëz të rëndomtë.

Ideja e bankave pa kamatë vazhdonte të zhvillohej në rrafshin shkencor-teorik, por edhe në rrafshin praktik. Tashmë njoh shumë të rinj myslimanë, që janë specializuar si ekonomistë në universitetet amerikane, ndërsa disertacionet e tyre kanë të bëjnë me kamatën dhe dobinë e braktisjes së saj gjatë

marrëdhënieve financiare bashkëkohore. Madje disa universitete kanë filluar të interesohen rreth parimeve ekonomike islame, duke organizuar seminare vjetore. Më e fundit nga ato ishte seminari i tetë i cili u mbajt në Prill të këtij viti, për të cilin na rrëfen profesori mysliman **Ali Khan**, profesor i drejtësisë në një nga universitetet e shtetit Kansas: “Ekonomia Islame ka filluar të tërheqë vëmendjen e shumë akademikëve, shumë prej pjesëmarrësve në seminar parashtronin dyshimin, se nëse i përmbahemi këtyre parimeve islame në ekonomi, a thua do të ketë mundësi t’i shpëtojmë bankat amerikane nga kokëçarja që po ndien tani”¹.

Pastaj ndodhi ngjarja, të cilën e transmeton agjencia e lajmeve islame, ku thotë: “Senati francez bën thirrje që sistemi islam i ekonomisë t’i bashkëngjitet sistemit bankar francez. Ky senat, në një raport që e përgatiti komisioni që merret me çështjet financiare pranë këtij senati u shpreh: “Sistemi bankar që bazohet mbi parimet islame është një sistem bankar, që i rehaton të gjithë, qofshin myslimanë apo jomyslimanë”.

Ky lajm do t’i shqetësojë shumë laikë të vendeve tona, madje duhet të shqetësohen, sepse fjalët e miradijes për sistemin bankar islam nuk do të kenë të ndalur. Bile, doemos të mençurit do t’i thonë vetes: Nëse kjo fe qenka e saktë në këndvështrimin e saj për ekonominë, nëse kapja pas parimeve të saj do të na shpëtojë nga fatkeqësitë ekonomike, ndoshta janë të sakta këndvështrimet e saja edhe për aspektet tjera. Ndoshta tanimë janë shprehur asisoj, sidomos kur të shohin se ajo ç’ndodhi me bankat e tyre është pasqyrim konkret i fjalës së Allahut: **“Allahu ia heq çdo përfitim kamatës...”**. (Bekare 276). A ke parë heqje më të madhe të përfitimit, sesa falimentimi i bankave, të cilat përfituan bilionë të shumtë me kamatë, ndërsa tani kanë nevojë për shpëtim?!

¹ <http://www.counterpunch.org/khan09272008.html>.

“...Ashtu ata hoxhallarë, të cilët ua bënë të lejuar muslimanëve të Perëndimit, që të blejnë shtëpi me kamatë, ndoshta tani do ta ndërrojnë qëndrimin...”

Prandaj ka mundësi që nga kjo derë edhe ata të hyjnë në fenë e Allahut dhe kjo nuk është për tu çuditur. Sepse dyert për të hyrë në këtë fe janë të shumta dhe secili që hyn nga një derë do ta gjejë veten së bashku me ata që kanë hyrë nga dyert tjera në sheshin e gjerë të së vërtetës.

Me një dozë keqardhjeje them: Nëse këto shembuj të vegjël të organizatave ekonomike islame tërhoqën këtë vëmendje të madhe, si do të ishte gjendja sikur të gjitha shtetet muslimane të ndërtonin jetën e tyre ekonomike mbi themelet e shariatit të Allahut. Ashtu do të sillnin një shëmbëlltje praktike, që do të bënte të qartë epërsinë e parimeve islame ndaj kapitalizmit dhe komunizmit. Do të arrinin ta gëzojnë njerëzimin, gjë të cilën nuk e arriti asnjë ideologji perëndimore. Por nëse këtë nuk e bënë në të kaluarën, ndoshta tanimë e kanë kuptuar gabimin dhe kthehen në udhëzimin e Zotit.

Po ashtu ata hoxhallarë, të cilët ua bënë të lejuar muslimanëve të Perëndimit, që të blejnë shtëpi me kamatë, ndoshta tani do ta ndërrojnë qëndrimin dhe do t’ua tërheqin vërejtjen muslimanëve nga pjesëmarrja në këso kontratash, që sjellin çrregullime në tokë, i cili ndodhi si rezultat i kontratave të kredive me kamatë në bankat e perëndimit. ■

Përktheu: Omer B.



PËRJETIME NGA HAXHI...

SHKRUAN: MIRSIM MALIQI

Lot gazi... Urime... Na përçafuan fort duke na porositur dhimbshëm me një zë të butë: “Mos na harroni në dua”. Bashkëvepruam në porosidhënie, që edhe ata të luten për ne, të kthehemi me Haxh të pranuar e lutje të përgjigjur, lutje në të cilat, emrat e tyre nuk do të mungonin inshaAllah.

Udhë e gjatë... Në fillim radhisja në kujtesë emrat e familjarëve, vëllezërve e hallexhinjve, duke e llogaritur se shumë shpejt do arrijmë në Medinën e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, e që aty të fillojmë të bëjmë dua për ta.

Ishte rrugë kujtimesh, që kaluam shumë vende, të cilat na kthenin në histori. Përkujtonim Perandorinë Osmane, kur

kalonim nëpër Turqi. Kurse Damaskun nuk e kaloje dot pa përkujtuar shumë pejgamberë, që u dërguan nga Allahu, azze ue xhele, në atë qytet shumë të lashtë. S'i harroje dot as emrat e ulemave, kolosëve e eruditëve të këtij Umeti, duke filluar nga Shejhu i Islamit, Ibën Tejmija, e deri te Shejh AbdulKadër Arnauti e Muhadithi i epokës Imam Nasirudin Albani, Allahu i pastë mëshiruar, që dhanë shumë për këtë Fe, e që jetuan aty.

Po edhe tek As'habul Kehf-i na u ngjallën shumë kujtime, aty ku Allahu solli shenja për Fuqinë e Tij Absolute. Kur shikoje sa larg ishte shpella nga rrafshi, të linte të kuptosh se për të ruajtur këtë fe ata ishin në gjendje jo vetëm të largoheshin nga luksi, por të përballonin edhe shumë-shumë sfida, nga përplasjet me armiqtë, e deri te mërzia për familjen. Ata kishin Istikame... Ata u përmendën në Kuran.

Hymë në Qytetin e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, ku në skajet e këtij qyteti vizitorët në radhë të parë ndaluan tek administrata për të dorëzuar pasaportat dhe ngrinin kokat se mos nga këtu do të shihnim minaret e xhamisë së Resulullahut, salallahu alejhi ue selem. Mu si ensarët që kishin hipur nëpër kodra për të parë të Dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ue selem, tek vinte në qytetin e tyre që u quajt Qyteti i të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem.

Ajo rrugë edhe pse qe shumë e gjatë, plot vështirësi e lodhje, me të hyrë në Qytetin e Ndriçuar u harrua, madje edhe po të ndaleshe pak për të rrëfyer gjithë atë rrugë, e shihje se është e rëndë, për të mos thënë e pamundur.

Jo, nuk i shkonte asnjërit prej nesh ndërmend tek çlodhja dhe pushimi, kur do të hymë në hotel, mirëpo përkundër porosive të mos dilnim jashtë vetëm, meqë s'e njihnim mirë qytetin, ne nguteshim që të shkojmë sa më shpejt tek Xhamia e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem.

E të falesh tek Kopshti i Xhenetit, që gjendet brenda vetë Xhamisë së të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem, është kënaqësi shumë e madhe. Ashtu sikurse edhe më mbresëlënëse është të falesh mu në vendin, ku i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, e ka falur namazin. Të vendosësh ballin mu aty ku e ka vendosur i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, ballin e tij të bekuar, a nuk është diçka e veçantë?!

E pas namazit shpejt e shpejt do të pyesnim dikë që e dinte: "Ku është varri i të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem?" dhe t'i jepnim një selam: Esselamu alejke ja Resulallah! E përshëndetëm me selam Vulën e Profetëve, i cili, alejhi salatu ue selem, në Keuther padyshim do t'u japë ujë pasuesve të tij të denjë, atyre që kudo

që ndodheshin në rruzullin tokësor zemrat i kishin të lidhura me Kuranin dhe Sunetin.

Kjo dëshirë e madhe për të ecur aty ku ka ecur i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, na shtronte në vetvete pyetjen: "Po sa po ecën Umeti rrugës-Sunetit të të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem?!" E kësaj pyetjeje iu përgjigjëm, se përpos Ehlu Sunetit dhe Xhematit, të tjerët janë në krizën e identitetit... Allahu qoftë në ndihmë!

Çfarë fitova më shumë në Medinën e Pejgamberit në përgjithësi, e në Xhaminë e të Dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ue selem, në veçanti?! Nga shumë të mira arrita njëmend të kuptoj vlerën e diturisë dhe bartësve të saj, e kjo u arrit në xhami, aty ku kishte dhjetëra ulema që ligjëronin bindshëm për fenë e Allahut... I riparashtroja vetes ato që thoshte Shejkh Mukbili, rahimehullah, se: "A ka gjë më të mirë sesa dija?! Ajo është më e mirë se ari dhe paratë, më e mirë se një grua e bukur dhe e mrekullueshme dhe më e mirë sesa privilegjet mbretërore." Kujtoja ato që kishte thënë një njeri i mençur se: "Muslimani arritjen e diturisë dhe ngritjen e vet intelektuale e sheh si mjet për arritjen e qëllimit, për ngritjen lart të fjalës **La ilahe il-Allah.**" Në Medinë edhe më shumë u motivova për të marrë rrugën e dijes, duke u vetëdijësuar siç thoshte një poet shqiptar se: "Dija nuk kapet me dorë, por as frika nuk largohet me dorë, që të dyja kapen dhe hiqen me mendje të hollë", e për t'u ngritur në këto piedestale fillimisht duhet ulur para bartësve të diturisë, se: "*Vërtet dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve; pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi, as dinarë, as dërhëmë, por ata kanë lënë si trashëgimi dijen, prandaj kush e merr ka*

marrë hisen më të bollshme.” (Hadith). Në Medine myslimani kalitet... Mëkëmbet... Sikurse nxënësi i dijes, i cili aty formohet, gatuhet, përparon dhe del për ta shpërndarë dijen në të gjithë globin.

Rruga për në Mekë të kujton Hixhretin e të Dërguarit të Allahut, alejhi salatu ue selam... Dhe ja, Meka me plot kodra, vendi ku lindi i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem.

Tavafi rreth Qabesë është kënaqësia më e madhe, që mund të përjetohet në Haxh. Duke shikuar Qabenë, duke lëvizur buzët që nxjerrin fjalë nga zemra me të cilat lavdërohet Mbreti i Qiejve dhe i Tokës, i cili robërve të Vet nëse i luten Atij u përgjigjet. Safa dhe Merua, dy kodra këto që me kujtime të çojnë edhe më larg nga epoka jonë... Deri te gruaja e Ibrahimit (Mikut të Allahut) alejhi selam, Haxhereja, e cila edhe sot mbetet shembull i qëndresës, durimit dhe i devotshmërisë për të gjithë muslimanët.

Kuptuam se namazi, dhikri, leximi i Kuranit, duatë në Harem, vërtetë përjetohen si askund tjetër. I pa të meta është Allahu, që lë shenja për robërit e Vet, në mënyrë që t’u shtohet imani në Madhërinë e Tij.

Meka kishte vende që qëndrimi dhe bujtja aty të kthente tek mënyra e jetesës së atyre, që i përkisnin brezit më të mirë, atij të artë. Ku qëndron kjo kthesë? Vërtet qëndron në Mina...

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ue selem, do ta përmendte të fundit (të pestin) Haxhin në hadithin rreth shtyllave të fesë. E në një hadith tjetër do të thoshte se: *“Haxhi është në Arafat”*.

Shtylla e parë e Islamit është Shehadeti,

pra, Teuhidi, e në Arafat fjala më e dashur tek Allahu, sipas një hadithi është fjala *“La ilahe ilAllahu, vahdehu la sherike leh, leahul mulk, ue leahul hamd, ue huve ala kuli shejin kadir”*, pra, fjalë e Teuhidit. Fillimi me Teuhid, sikurse edhe shtylla e fundit e Islamit me Teuhid.

Është fjala La ilahe ilAllah, për të cilën Allahu, më i Larti, krijoi qiejt dhe tokën, ditën dhe natën, xhindet dhe njerëzit, dhe gjithçka që ekziston. Për këtë fjalë shkohet në Haxh. Për fjalën La ilahe ilaAllah, prandaj Allahu, më i Larti, thotë: ***“Për hir të Allahut, vizita e shtëpisë (Qabes) është detyrim për atë që ka mundësi udhëtimi tek ajo, e kush nuk e beson (ai nuk e viziton); Allahu nuk është i nevojshëm për (ibadetin që i bëjnë) njerëzit”***. (Ali Imran: 96-97).

Nëse në mëngjeset e verës, lulet e freskëta janë shumë më të bukura, kur mbulohen nga vesa, besimtarët janë shumë të bukur në Arafat, kur përloten duke e lutur të Mëshirshmin, Falësin, Dhuruesin, Atë që Lartmadhëruar qoftë, në atë vend liron shumë robër të Tij nga Zjarri dhe ua falë mëkatet.

Abdullah b. Mubareku do të pyeste në Arafat Sufjan b. Ujejnen se: “Kush është më i keqi në këtë grumbull njerëzish? E ai iu përgjigj: Ai që mendon se Allahu nuk ia fal”.

“O Allah! Ti e di pse kam ardhur këtu!”, kështu kishte bërë dua një plaku ynë në Arafat!

Uel hamdu lilahi rabil alemin!

P.S. T’i thuash dikujt: “Na përshkruaj pak, si e kalove në Haxh” zakonisht merr përgjigjen se është shumë e vështirë, apo edhe e pamundur. Për të mos thënë të njëjtën gjë shkrova ato që përjetova, duke i ikur ndonjë stili barok, për të qenë sa më origjinal, i shkurtër dhe i qartë. ■



A JANË VEPRAT KUSHT I DOMOSDOSHËM PËR IMANIN, APO JANË VETËM KUSHT PLOTËSUES?

Nuk është e saktë të thuhet pa u kufizuar, se veprat janë kusht i domosdoshëm apo kusht plotësues për besimin; prandaj duhet patjetër të jemi të qartë kur flasim për këtë pikë.

ABDURRAHMAN B. NASIR BERRAK

Disa prej nxënësve të dijes kanë pyetur dhe pyesin për një temë që është shumë e përfolur në këtë kohë.

Teksti i pyetjes: “A janë veprat kusht i domosdoshëm për imanin, apo janë vetëm kusht plotësues? A mund të konsiderohet arsye (shfajësuese) edukimi i keq, që të falet ai që mohon (bëhet fjalë për kufirin) duke sharë/ofenduar Allahun ose të Dërguarin e Tij?”

Le të fillojmë me pjesën e parë, ku thuhet: “A janë veprat kusht i domosdoshëm për imanin, apo janë vetëm kusht plotësues?”

Përgjigjja: E themi me plot bindje, se Kurani e Suneti kanë treguar se imani si term

përmbledh në vetvete:

1. Besimin me zemër, pranimin dhe pohimin.

2. Pohimin me gojë.

3. Të vepruarit me zemër, që nënkupton nënshtrimin, dëshirën dhe çdo gjë që ka statusin e këtyre të dyjave, si për shembull: mbështetja, shpresa, frika dhe dashuria.

4. Të vepruarit me gjymtyrë, duke futur këtu edhe gjuhën. Me të vepruarit kemi si qëllim punën që përfshin veprat dhe ndalesat foljore dhe veprore.

Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: “*O besimtarë! Besoni Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij, të Dërguarit e Tij dhe Ditën e Kijametit, ai, me të*

vërtetë ka humbur larg prej udhës së drejtë.”

Gjithashtu Zoti thotë: ***“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu fërgëllojnë dhe kur u lexohen ajetet e Kuranit, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten, ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë. Ata janë besimtarët e vërtetë. Ata do të kenë shkallë përnderimi te Zoti i tyre, falje dhe furnizim bujar në Xhenet”.***

Më tej Allahu thotë: ***“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirimin e të robëruarve; e atij që fal namazin dhe jep zeqatin; dhe e atyre që i realizojnë premtimet; e atyre që durojnë në kohë të vështira dhe luftime. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun”.***

Siç thotë gjithashtu: ***“Kushdo që mohon Allahun, pas pranimit të besimit (do të dënohet ashpër), përveç atij që është i detyruar me forcë, ndërkohë që zemra e tij është e qetë me besimin. Ndërsa ata që i hapin zemrën mosbesimit, do të kenë mbi vete zemërimin e Allahut dhe një dënim të madh”.***

Ajete të tilla me këtë kuptim janë të shumta në Librin e Zotit.

Në të dy ‘përmbledhjet e sakta’ të haditheve, atë të Buhariut dhe të Muslimit, përcillet nga Ibën Abasi, se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, iu drejtua delegacionit të fisit Abdul Kajs me këto fjalë:

-“Kush jeni ju?”

-“Rebia”.

-“Mirë se vini, o njerëz të nderuar dhe të respektuar, të papërlur e të paqortuar!”

-“O i Dërguar i Allahut, ne kemi mundësi të të vizitojmë vetëm në muajt e shenjtë, pasi

ndërmjet nesh dhe teje ndodhet një degëzim i fisit Mudar, të cilët nuk janë besimtarë, ndaj na urdhëro me diçka, të cilën t’ua urdhërojmë edhe të tjerëve, e kësajsoj të hyjmë në Xhenet nëse e zbatojmë?”

Gjithashtu ata e pyetën Profetin, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, edhe lidhur me pijet që përdornin. Ndërkohë ai i urdhëroi për besimin tek Allahu, Një të Vetëm.

-“A e dini se ç’është besimi tek Allahu, Një e të Vetëm?”

-“Allahu dhe i Dërguari i Tij e dinë më mirë”!

-“Besimi është të dëshmosh ‘La ilahe il-Allah’ (Nuk ka të adhurar me të drejtë përveç Allahut) ‘Muhamedun Resulullah’ (Muhamedi është i Dërguari i Allahut), të kryesh faljen rregullisht, të japësh zekatin, të agjërosh Ramazanin dhe të japësh prej plaçkës së luftës një të pestën”.

Pasi ju tregoi detyrimet Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, i ndaloi nga katër gjëra:

-“Jua bëj të ndaluara pijet e prodhuara në enët e Hantemit, Dubait, Nekirit dhe Muzefet. Vini vesh mirë dhe lajmëroni edhe të tjerët”.

Në të dy ‘përmbledhjet e sakta’ gjithashtu përcillet nga Ebu Hurejra, se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: ***“Besimi përbëhet nga gjashtëdhjetë e sa degë. Turpi është një prej degëve të besimit”.***

Përsëri në të dy ‘përmbledhjet e sakta’ përcillet nga Ebu Hurejra, se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, kur u pyet se cila është puna më e mirë, tha:

-“Besimi tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij”.

-“Po më pas?”

-“Xhihadit për fenë e Allahut”.

-“Po pastaj?”

-“Haxhi i pranuar”.

Imam Muslimi në “Sahihul Muslim” ka

shënur një hadith, që e përcjell Ebu Seid Hudriu, se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *“Kushdo nga ju, që sheh një të keqe, ta ndryshojë atë me dorën e tij; e nëse nuk ka mundësi, me gjuhën e tij; e nëse sërish nuk ka mundësi, ta ndryshojë me zemrën e tij. Por ta dini se ky është besimi më i dobët”*.

Imamët e mëdhenj të Ehli Sunetit, të gjithë e kanë përcjellë dhe e kanë paraqitur këtë që u përmend më lart: si imam Malik b. Enesi, Euzai, Ibën Xhurejxhi, Sufjan Theuriu, Sufjan b. Ujejne, Ueki b. Xherrahu e shumë të tjerë. Të gjithë kanë pohuar njëzëri: **“Imani (besimi) përbëhet nga shprehjet, fjalët dhe nga veprat”**.

Termi “shprehje”, nënkupton ‘shprehjet e gjuhës dhe të zemrës’ dhe termi “vepra” nënkupton ‘veprat e zemrës dhe ato të gjymtyrëve’.

Dijetari i famshëm i Islamit Ibën Tejmije në veprën e tij El Akidetul Uasitijeh ka thënë: *“Një prej bazave të Ehli Sunetit është fakti, se feja dhe besimi nuk janë gjë tjetër veçse shprehje dhe vepra. Pra, shprehjet e zemrës dhe të gjuhës dhe veprat e zemrës, të gjuhës dhe të gjymtyrëve”*.

Duke pasur parasysh këtë, na bëhet e qartë se termi ‘iman’ përfshin dhe përmbledh çdo gjë që ka urdhëruar Allahu dhe i Dërguari i Tij, në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me besimet, dëshirat, veprat e zemrës, shprehjet e gjuhës, veprat e gjymtyrëve dhe heqja dorë nga ndalesat. Pra, e thënë ndryshe, përmbledh të gjitha detyrimet dhe veprat e pëlqyera, si dhe lënien e të gjitha ndalesave dhe veprave të papëlqyera; gjithashtu edhe të konsideruarit e diçkaje hallall, kur ajo është hallall dhe të konsideruarit e diçkaje haram, kur është haram.

Urdhëresat dhe ndalesat, nuk janë në të njëjtën gradë, madje e njëjta gjë vlen edhe për gjërat e pëlqyeshme dhe ato të papëlqyeshme. Për këtë arsye nuk është e

saktë të thuhet pa u kufizuar, se veprat janë kusht i domosdoshëm apo kusht plotësues për besimin; prandaj duhet patjetër të jemi të qartë kur flasim për këtë pikë.

Shprehja jonë ‘veprat’ përfshin veprat e zemrës, dhe veprat e gjymtyrëve, dhe kryerjen e disa veprimeve dhe heqjen dorë prej disa veprimeve të tjera, pra, përmbledh pesë shtyllat e Islamit dhe detyrimet e tjera. Në të njëjtën kohë këtu futet heqja dorë prej idhujtarisë, mosbesimi (blasfemitë) dhe gjynaheve të tjera. Të heqësh dorë prej shirkut dhe llojeve të kufrit dhe nga ana tjetër të distancohesh prej tyre janë kusht i domosdoshëm për besimin. Nuk ka besim me praninë e tyre. Ndërsa heqja dorë prej gjynaheve të tjera është kusht plotësues për besimin.

Nënshtimi i zemrës në pasimin e të Dërguarit, e çdo gjë që është e domosdoshme në këtë drejtim: siç janë veprat e zemrës, dashuria për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, frika, shpresa etj.; që të gjitha këto konsiderohen si kushte të domosdoshme për besimin, pa të cilat nuk është i mundur besimi i mirëfilltë.

Po kështu edhe pohimi me gjuhë i dëshmisë **“La ilahe il-Allah Muhamedun resulullah”** (Nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Allahut), konsiderohet kusht i domosdoshëm për besimin, përndryshe nuk ka besim.

Sa i takon Shtyllave të Islamit, që vijnë pas shehadetit, Ehli Suneti (vijuesit e traditës profetike), nuk kanë mbajtur të njëjtin qëndrim për to, se: a janë kusht i domosdoshëm për besimin, që nënkupton se nëse lihen përbën kufër (mosbesim) apo jo. Mospajtimi kryesor është e shfaqur më shumë tek lënia e pesë kohëve të namazit, e faljeve ditore, pasi namazi konsiderohet shtylla më e rëndësishme pas shehadetit. Dhe ngaqë për namazin në veçanti kanë

ardhur argumente të posaçme që tregojnë mbi mosbesimin e atij që e lë, siç është hadithi i Xhabirit, që e transmeton Imam Muslimi e të tjerë, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, duke thënë: *Shenja që e dallon njeriun besimtar nga ai jobesimtar dhe besimin nga jobesimi: është lënia e namazit*”. Gjithashtu Burejde b. Husejni përcjell se i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: “*Shenja dalluese ndërmjet besimtarëve dhe jobesimtarëve është namazi, kush nuk e kryen ka mohuar.*” Ky hadith përcillet në librat e Suneneve.

Ndërsa për sa i përket gjykimin rreth detyrimeve të tjera pas Shtyllave të Islamit, nuk ka mosmarrëveshje ndërmjet ithtarëve të Ehli Sunetit, në faktin që veprimi i tyre është kusht plotësues e jo i domosdoshëm për besimin. Pra, lënia e tyre konsiderohet prej gjynaheve që nuk e nxjerrin njeriun nga besimi.

Sa për dijeni, kur themi ‘kusht’, rrahim të përmendim një kuptim më të gjerë se sa ai që njihet; me pak fjalë, kemi si qëllim, “diçka prej së cilës varet ekzistenca e diçkaje, pa bërë dallim se është pjesë përbërëse apo jashtë saj”. Pra, nuk duhet keqkuptuar: me përcaktorin ‘kusht’ nënkuptojmë njëherësh edhe atë gjë ose atë vepër, që është pjesë përbërëse, pra, shtyllë.

Ky është qëndrimi i Ehli Sunetit, për këtë arsye nuk lejohet që të thuhet, se kush ka thënë “ai që e lë namazin apo ndonjë shtyllë tjetër të fesë, si shkak i përtacisë nuk bën kufër” - duke u arsyetuar përmes saj - quhet murxhi . Sikundërse nuk lejohet të quhet havarixh ai që thotë (për lënësin e namazit) “bën kufër”.

Njeriu quhet murxhi, atëherë kur ai predikon shkëputjen e veprave nga besimi (veprat e zemrës e të gjymtyrëve), megjithëse mund të konfirmojë

detyrueshmërinë e tyre dhe - nga ana tjetër - lënien ndalesave dhe në të njëjtën kohë pranon gjykimet penale ose ndëshkimet; kjo është thënia e murxhive fukaha (murxhive dijetarë të jurisprudencës). Mirëpo këtë predikim/mendim e kanë kundërshtuar imamët e mëdhenj të dijes dhe kanë treguar se bie ndesh me Kuranin dhe Sunetin e të Dërguarit (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të). Në qoftë se dikush thotë: “Imanin nuk e dëmton asnjë mëkat dhe besimi nuk është gjë tjetër përveçse njohuri; të njohësh Zotin, pra, dituri”, padyshim ky është pohimi i murxhive ekstremistë, që njihen ndryshe si xhehmij dhe që dijetarët e selefëve i kanë konsideruar si jobesimtarë.

Me kaq sa u tha më lart përfundon edhe sqarimi i çështjes së veprave, në lidhje me imanin, pra, çështja se a konsiderohen kusht i domosdoshëm e i patjetërsueshëm apo vetëm kusht plotësues për ekzistencën e tij. Siç u sqarua po ashtu edhe medhhebi, pra, qëndrimi i murxhive në këtë temë. Nuk e di nëse ndonjëri nga imamët e mëhershëm të ketë folur me këtë terminologji, ndërsa te disa të mëvonshëm vihet re që e përdorin.

Njëkohësisht jemi përgatitur për t'i dhënë përgjigje, dy pyetjeve:

Jobsimtari (qafiri), që është i tillë që në origjinë, çfarë duhet të bëjë që të hyjë në Islam, që si pasojë të gëzojë të drejtat e muslimanëve?

Çfarë e nxjerr muslimanin nga Islami, duke qenë zotërues i këtij statusi, e për rrjedhojë të konsiderohet jobesimtar (qafir)?

Vijon në numrin e ardhshëm: Mbi imanin dhe gjërat që e bëjnë të pavlefshëm. ■

Shqipëroi: Ahmed KALAJA

ADHURIMI JONË GJATË DIMRIT

PËRGATITI: OMER BERISHA

Jemi në dimër dhe moti ndryshon, ndërsa në sërish duhet të vazhdojmë rrugëtimin tonë drejt mëshirës dhe xhenetit të Allahut, duke e adhuruar Atë, të Vetmin me sineritet dhe në formën si na ka mësuar i Dërguari i Tij, salAllahu alejhi ue selem. Një gjë të tillë kemi mundësi ta bëjmë shumë lehtë gjatë dimrit, për shkak të kohës së lirë që mund ta gjejmë në këto ditë. Meqë gjurmët e adhurimit ndaj Allahut vërehen në çdo gjë dhe ato gjëra ndryshojnë nga vera në dimër, atëherë le t'i mësojmë çështjet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me ibadetin tonë ndaj Allahut gjatë dimrit...

Rreth pastërtisë dhe abdesit

Allahu i Madhëruar thotë: **“...dhe nga qielli zbritëm ujë të pastër”**. Imam Begaviu sqaron: “I pastër në vete dhe pastrues për tjetrin”,

d.m.th., nuk ka asnjë pengesë që të merret abdes me atë ujë, qoftë shi apo borë. Marrja e abdesit në këtë gjendje ka edhe shpërblimin e dalluar, Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: **“...dhe tri gjëra që shlyejnë mëkatet – ku mes tjerash përmendi – përkryerja e abdesit kur bën ftohtë”**. Ta përkryejmë abdesin jemi të urdhëruar ndërsa në raste dimri dhe vështirësie shpërblimi shtohet. T'i lash të gjitha pjesët e abdesit mirë e mirë, madje t'i lash më shumë sesa je i detyruar, kjo quhet përkryerje e abdesit. Me këtë rast dua të përmend tre çështje:

a. Gjatë ditëve të ftohta, disa njerëz lëre që nuk përkryejnë abdesin, ata madje nuk i lajnë as ato që janë të domosdoshme, saqë bëjnë vetëm fërkimin e pjesëve me duar të lagura. Kjo nuk lejohet në asnjë mënyrë, madje mund të quhet edhe prej prishësve të abdesit. Disa të tjerë nuk i ngrenë mëngët deri mbi bërryla, që t'i lajnë krahët me gjithë bërryla, edhe kjo



është haram dhe në këtë mënyrë abdesi nuk është i vlefshëm.

b. Disa njerëz ngurrojnë të ngrohin ujin për abdes, ndërsa për këtë gjë nuk kanë asnjë argument nge Feja. Megjithëse ka hadithe që lëvdojnë përkryerjen e abdesit gjatë vështirësive dhe të ftohtit, dijetari El Ubej thotë: “Ngrohja e ujit për abdes, që pastaj të kryhet me lehtësi adhurimi, nuk pengon arritjen e atyre shpërblimeve”.

c. Disa njerëz ngurrojnë të fshijnë ujin e abdesit nëpër gjymtyrë, duke menduar se do bëjnë gjynah, por kjo nuk ka bazë, përkundrazi është vërtetuar se Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, kishte një pëlhurë me të cilën thante gjymtyrët pas abdesit.

Gjatë dimrit gjithashtu shtohen shirat dhe lloçi, të cilat shpesh i përlyejnë rrobat dhe një gjë e tillë mund të jetë problem për dikë, por atyre u themi: Nuk ka nevojë t'i lash ato rroba që janë përlyer me lagështi apo copa lloçi, sepse ai është i pastër, si dhe është vërtetuar nga një numër i madh tabiinësh, se ata zhyteshin në shi e lloç dhe pastaj hynin në xhami. E njëjta gjë vlen edhe nëse ndonjë pikë lagështie bie në rroba dhe njeriu nuk e di: a është e pastër apo jo? Ai nuk detyrohet të pyesë se çfarë është, sepse kjo gjë vetëm se ia shton vesvesen atij. Përveç nëse ka bindje se në të ka ndyrësi, atëherë detyrohet ta lajë pjesën e përlyer.

Tejemumi

Ai që nuk gjen ujë apo nuk ka mundësi ta përdorë atë për shkak të largësisë apo të ftohtit të madh dhe nuk ka mundësi ta ngrohë, atëherë i lejohet të merr tejemum dhe të falet, duke mos e përsëritur namazin pasi të gjejë ujin.

Tejemumi merret duke prekur tokën një herë me të dy duart dhe duke e fërkuar fytyrën dhe pastaj duart. Në thelb duart duhet të prekin dheun, nëse jo, atëherë mundet edhe gurin, zallin dhe të ngjashme.

Mes’hu (fërkimi) mbi këpucë apo çorape

Prej lehtësimeve fetare është se në vend që të lahen këmbët gjatë abdesit, të mjaftohemi vetëm me fërkimin e këpucëve, mesteve apo çorapeve. Ibën Dekik el-Idi thotë: “Te dijetarët e sheriatit është i njohur lejimi për mes’hun mbi këpucë, madje ajo është bërë simbol i Ehli Sunetit, ndërsa mohimi i kësaj është bërë simbol i shiave”. Dijetari Muhamed Xhemaludin Kasimi i tuboi hadithet që flasin për mes’hun mbi çorape në një libër që e quajti **“Mes’hu mbi çorape”**.

Rreth mes’hut mbi meste, këpucë apo çorape duhet të dimë:

- Çorapet dihet çfarë janë, gjithçka pra, që vishet në këmbë dhe nuk është prej lëkure, pavarësisht janë të holla apo të trasha quhet çorap. Mbi të gjitha këto lejohet të jepet mes’h. Nëse janë të shqyera gjithashtu lejohet të jepet mes’h mbi to, përveç nëse janë të shqyera aq shumë, saqë nuk mund të quhen çorape dhe nuk mund të ecet me to, atëherë nuk lejohet. Pjesë-pjesë ishin të shqyera edhe këpucët e muhaxhirëve dhe ensarëve, për shkak të varfërisë që kishin, e sikur shqyerja të ishte pengesë për mes’hun, këtë do t’ua bënte të qartë i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem.

- Çorapet, mestet apo këpucët mbi të cilat vlen të merret mes’h janë ato, të cilat vishen duke pasur abdes.

- Kohëzgjatja e mes’hut për vendasin është një ditë e një natë ndërsa për udhëtarin tre ditë e tri net. Numërimi i kohëzgjatjes fillon që nga mes’hu (fërkimi) i parë.

- Zbathja e çorapeve, mesteve apo këpucëve nuk e prish abdesin, por e humb të drejtën e fërkimit të sërishëm të tyre. Gjithashtu abdesin nuk e prish edhe mbarimi i kohëzgjatjes së mes’hut.

Ezani

Në një ditë me shi, Ibën Abasi, radijAllahu anhuma, i kishte thënë muezinit: pasi të

thërrasësh: “ue eshdedu enne muhammeden resulullah – dhe dëshmoj se Muhamedi është i dërguar i Allahut” mos thërrit “hajj ales salah – ejani në namaz”, por thërrit: “sal’lu fi bujutikum – faluni në shtëpitë tuaja”. Një veprim i tillë nuk u pëlqeu njerëzve, ndërsa ai tha: *Kështu ka vepruar ai që ishte më i mirë se unë...*; gjithashtu Ibën Omeri, në një natë të ftohtë në Daxhnan thërriti ezanin, pastaj tha: Faluni aty ku jeni, dhe na lajmëroi se i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, gjatë netëve të ftohta dhe ato me shi, në udhëtim, urdhëronte një muezin të thërriste ezanin, i cili në fund do të shtonte: **Faluni aty ku jeni.**

Nga këto hadithe mësojmë lehtësimin e jo-pranisë në namazin me xhemat me arsye. Kurtubiu ka thënë: “Shihet qartë se lejohet të mos jesh i pranishëm në xhemat, për shkak të vështirësisë së shiut, erës, të ftohtit dhe të ngjashmeve që shkaktojnë vështirësi, qoftë kur je vendas apo në udhëtim”.

Mësojmë se në vend të fjalisë: “Hajje ales salah” duhet thënë: “Sal’lu fi rihalikum”, por nëse nuk e thotë, nuk prish gjë. Të falesh në shtëpi apo aty ku je në këso rastesh është e lejuar dhe jo detyrim (vaxhib), prandaj nëse dikush shkon që të falet me xhemat në këso rastesh, ai nuk ka bërë asnjë gabim, përkundrazi ai shpërblehet për këtë. Por edhe ai që nuk shkon në xhami nuk ka bërë gabim, sepse ka shfrytëzuar një nga lehtësimet e kësaj Feje.

Namazi

- Bashkimi i namazeve

Ibën Abasi ka thënë: *“Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, fali të bashkuara drekën dhe iqindinë, si dhe akshamin me jacinë pa pasur shi apo ndonjë frikë.* E pyetën: Pse veproi ashtu? *Që të mos ia vështirësojë Umetit – u përgjigj ai”.*

Abdullah b. Shekiku rrëfen: Një ditë pas iqindisë Abdullah b. Abasi na ligjëroi derisa

“Te dijedarët e sheriatit është i njohur lejimi për mes’hun mbi këpucë, madje ajo është bërë simbol i Ehli Sunetit, ndërsa mohimi i kësaj është bërë simbol i shiave...”

perëndoi dielli dhe filluan të shihen yjet. Njerëzit tregonin shqetësim: Namazi! Namazi! Pastaj, iu afrua një njeri nga fisi Beni Temim dhe i tha: Namazin! Namazin! Ibën Abasi ia ktheu: **Mjerë nëna që të ka, ti dëshiron t’ma mësosh Sunetin?!** E kam parë të Dërguarin, salAllahu alejhi ue selem, bashkoi drekën me iqindinë dhe akshamin me jacinë. Abdullah b. Shekiku shtoi: Nuk isha i qetë në shpirt, ndaj shkova ta pyes për këtë Ebu Hurejren dhe ai e vërtetoi të njëjtin veprim.

Duke u bazuar në këtë hadith Imam Shafiu arsyeton bashkimin e drekës me iqindinë dhe akshamin me jacinë me xhemat në rast shiu, por edhe bore. Imam Maliku dhe Imam Ahmedi e lejojnë këtë për aksham dhe jaci, por jo edhe për drekë dhe iqindi. Në këtë çështje më i rreptë është Imam Ebu Hanife, i cili nuk e lejon bashkimin e namazeve në asnjë mënyrë. Por mendimi më i saktë është ai që është në pajtim me fjalët e Ibën Abasit. Allahu e di më së miri.

Gjatë këtij bashkimi të namazeve duhet thirrur një ezan dhe pastaj për secilin namaz nga një ikamet.

Ndërsa sunetet e këtyre namazeve duhen falur pas faljes së farzeve tërësisht. P.sh.: Thirret ezani për kohën e akshamit, pastaj ikameti, falet farzi i akshamit, pastaj thirret ikameti për jacinë, falet farzi i jacisë e pastaj falen sunetet e akshamit, sunetet e jacisë dhe

namazi i vitrit, edhe pse akoma s'ka hyrë koha e jacisë.

Dispozita të tjera rreth namazit

- mbulimi i gojës dhe mbulimi i duarve gjatë namazit.

I Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, ka ndaluar mbulimin e duarve gjatë namazit dhe mbulimin e gojës. Këto gjëra mund të ndodhin më shpesh gjatë dimrit, duke mbështjellë gojën me shall, ose duke hedhur një batanije mbi shpatulla, me të cilat do t'i mbulojë edhe duart. Ndaj po tërheqim vërejtjen duke treguar se këto veprime janë të ndaluara, përveç në raste kur i ftohti është i padurueshëm.

- mbajtja e dorezave.

Disa mendojnë se mbajtja e dorezave është sikurse mbulimi i duarve me batanije dhe kështu e ndalojnë edhe mbajtjen e dorezave, por kjo nuk është e vërtetë. Pra, mbajtja e dorezave nuk prish punë.

- falja e namazit përballë zjarrit.

Gjatë ditëve të dimrit shtohet përdorimi i aparateve të nxehjes të ndryshme dhe shpeshherë ato janë në drejtim të kibles dhe shkëlqejnë para syve të falësve kur ata falen. Kjo gjë nuk lejohet, sepse është përngjasim me adhuresit e zjarrit, ndërsa i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Kush i ngjan një populli, ai është prej tyre”*. Gjithashtu ka ndaluar që falësi të jetë përballë gjithçkaje, që do t'ia prishte përqendrimin dhe përruljen gjatë namazit.

- falja e namazit në veturë apo autobus nga frika e dëmtimit.

Ibën Kudame në librin “el-Mugni” ka thënë: *“Nëse dëmtohet nga të bërit sexhde, ose nuk dëshiron t'i përlyejë duart dhe rrobat në baltë dhe lagështi, atëherë mund të falet mbi kafshën e tij dhe bën shenjë për sexhden”*. Ibën Tejmije ka thënë: *“Të falësh namazin farz i hipur mbi kafshë nga frika se do t'i ikin bashkudhëtarët, apo nga frika se do të dëmtohet nëse zbret, është veprim i saktë”*.

Xhamitë

- ndërprerja e safeve për shkak të aparateve të nxehjes

Albani duke folur për çështjen e namazit mes shtyllave dhe këputjes së safeve ka thënë: E ngjashme me shtyllat është edhe vendosja e aparateve nxehëse nëpër disa xhami në atë mënyrë që i ndërpresin safet. Ky është një gabim që ndoshta nuk e vëren, as imami, as ndonjëri prej falësve. Kjo ndodh sepse shumë njerëz nuk i dinë ligjet e Fesë, por edhe për shkak se pak njerëzve u intereson nëse bëjnë gabim apo jo.

- poterja për shkak të (jo)bashkimit të namazeve

Kjo ndodh shpesh dhe në shumë xhami, saqë thuhet shumë fjalë të pahijshme dhe bëhet potere e hatashme, me shumë injorancë dhe me pak dije. Njëri thotë: Të bashkuara duhet t'i falim! Jo, ende nuk duhet – ia kthen tjetri. Ndërsa i treti e ndihmon të dytin, i katërti të parin e kështu me radhë. Që kjo mesele të jetë e qartë, po përkujtojmë dy gjëra:

a. imami i xhamisë është i ngarkuari që merr vendimin dhe ai mban përgjegjësinë e atij vendimi mes tij dhe Zotit. I Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Imami është garanci, nëse vepron mirë ka shpërblim ai dhe ata, e nëse gabon, ai mban përgjegjësinë, ndërsa ata kanë shpërblim”*. Kush i bindet vendimit të imamit është më mirë, por ai që nuk pajtohet le të falet me imamin me nijet për namaz vullnetar dhe pastaj le të shkojë i qetë dhe pa bërë asnjë potere.

b. xhamitë kanë pozitën, nderin dhe kari-zmin e tyre, ndaj nuk lejohet të nëpërkëmben ato. Omeri, radijAllahu anhu, i kishte parë dy njerëz në xhami dhe i kishte thirrur për t'i pyetur: Prej nga jeni ju? Nga Taifi – u përgjigjën. *Sikur të ishit nga Medina do t'ju kisha rrahur, si mund të ngrini zërin në xhaminë e Resulullahut, salAllahu alejhi ue selem?*

Disa lutje

- Duaja me rastin e erës

Allahumme inni es`eluke hajreha ue hajre ma fiha, ue hajre ma ursilet bihi, ue eudhu bike min sherriha ue sherri ma fiha, ue sherri ma ursilet bihi. – O Zot, kërkoj nga Ti të mirën e saj, të mirën që del prej saj, të mirën që është dërguar me të, më mbro prej të keqes së saj, të keqes që del prej saj dhe prej të keqes që është dërguar me të.

- Duaja kur murmuron (bubullin)

Subhanel ledhi jusebbihur ra`du bi hamdihi uel melaiketu min hifetihi – I Lartmadhëruar qoftë Ai, që e madhëron murmurima (bubullima), me falënderimin e Tij, e edhe melaiket (e madhërojnë) prej frikës ndaj Tij.

- Duatë për kërkimin e shiut apo borës (ISTISKA)

Allahumme eskina gajthen mugithen, merien meri'an, nafian gajre darr, axhilen gajre axhil. – O Zot, të lutem na lësho shi ndihmues, të lehtë dhe frytdhënës, të dobishëm e jo të dëmshëm, të menjëhershëm e jo të vonuar.

- Duaja kur bie shi apo borë

Allahumme sajjiben nafian – O Zot, kërkoj shi të madh, të dobishëm.

- Duaja pasi bie shi apo borë

Mutirna bi fadlilahi ue rahmetihi – U furnizua me shi nga mirësia dhe mëshira e Allahut.

- Duaja kundër vërshimit

Allahumme havalejna la alejna. Allahumme alel akami uedh dhirabi, ue butunil eudijeti, ue menabitish shexher. – O Zot, rreth nesh e jo mbi ne. O Zot, ktheje kodrave dhe kodrinave, luginave dhe pyjeve.

(Shumica e mësimeve në këtë shkrim janë të përfituara nga libri “Ahkamu Shita fi Sunetil Mutahhere” të dijetarit Ali b. Hasen Halebit. Këtu i kam sjellë në formë të shkurtuar dhe me ca shtesa të dobishme.) ■

BILANCI VJETOR I MYSLIMANIT

Për besimtarin është e rëndësishme hartimi i një strategjie jetësore, duke programuar çdo aktivitet jetësor. Ai duhet të interesohet për çdo lëvizje që të jetë në përputhje me mësimet e besimit

SHKRUAN: ULVI FEJZULLAHU

Ditët shkojnë, vitet ecin, jeta pakësohet, vdekja afrohet. Njeriut nuk i mbetet asgjë tjetër vetëm se të ndalet dhe të mendojë për aktivitetin e kaluar. Ai duhet të ndalet dhe të mendojë për veprimet.

Vallë, a ka kontribuar më shumë për të mirën apo për të keqen?!

Cilat janë arritjet e tij gjatë vitit që lamë prapa?

Libri i tij çfarë shënimesh përmban?

I mençur është ai që bën llogari para se t'i nënshtrohet llogarisë së Allahut të Lartësuar. Në prag të përfundimit të çdo viti kompanitë tregtare janë të detyruara që të bëjnë llogarinë dhe bilancin vjetor, duke kontrolluar dhe analizuar hyrjet dhe daljet, faturat etj., dhe në saje të rezultateve hartohet plani buxhetor për vitin e ardhshëm dhe biznes-planin për t'i realizuar projektet e reja.

Kështu veprojnë organizatat e ndryshme, shtetet e mëdha dhe të vogla,



kontrollojnë, përmirësojnë, planifikojnë, hartojnë...

Vallë! Pse shumë prej nesh kalon viti ndoshta edhe shumë vite të jetës duke mos menduar fare për të marrë në llogari vetveten?! Llogari për ditët, javët, muajt, vitin e dekadat e kaluara të jetës sonë!

Kështu kalon jeta duke mos u ndalur për të menduar vetëm edhe një moment:

Vallë çfarë jam duke bërë; cilat janë humbjet dhe arritjet gjatë këtij viti?!...

Kur ndonjëri humb diçka nga pasuria trazohet e gjithë dynjaja. Kur e humb një mik të dashur shqetësimi i tejkalon kufijtë e normales. Ndërsa i shkon një pjesë e jetës me të cilën nuk ka mundësi ta zhdëmtojë dhe ta rikthejë.

Për besimtarin është e rëndësishme hartimi i një strategjie jetësore, duke programuar çdo aktivitet jetësor. Ai duhet të interesohet për çdo lëvizje që të jetë në përputhje me mësimet e besimit. Është e rëndësishme që të kujdesemi për kohën, se ku do ta kalojmë edhe për këtë do të japim

llogari para Allahut të Lartësuar. Koha është gjëja më e shtrenjtë për besimtarin, ajo është pjesë e pandashme e tij, kur shkon një ditë ka shkuar një pjesë e jetës së tij. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Njeriu nuk do të lëvizë pa iu përgjigjur katër pyetjeve: Ku e ke kaluar jetën? Çfarë ke punuar me dijen tënde? Si e ke fituar pasurinë tënde dhe ku e ke harxhuar? Ku e ke lodhur trupin tënd?”* (E përcjell Tirmidhiu, hadithi është hasen.)

Dita e Llogarisë është një ditë ku njeriut i paraqitet çdo detaj nga jeta e kësaj bote, Allahu i Lartësuar thotë: *“(Kini frikë) ditën, kur çdokush do ta gjejë përpara atë që ka punuar mirë dhe atë që ka punuar keq, duke dëshiruar që midis tij dhe së keqes së tij, të ketë një largësi të madhe. Allahu ju paralajmëron që t'i ruheni Vetes së Tij. Allahu është i Butë e i Mëshirshëm me robërit e Vet.”* (Ali Imran 30).

Këto janë fakte dhe argumente për ata që mendojnë dhe dëshirojnë një përfundim të mirë në këtë botë dhe llogari të lehtë në

Ditën e Llogarisë.

Të nderuar! Dëshiroj t'ia kujtoj vetes më parë dhe juve disa porosi, ku Allahu i Lartësuar na tregon se për çdo aktivitet të ushtruar në këtë botë do të ketë dëshmitarë të shumtë nga të cilët nuk ka mundësi askush t'i ikë. Atëherë mendoje, o njeri, për kohën që po kalon dhe ti nuk po lodhesh fare, se si e kalon atë, a në kënaqësinë e Allahut apo në hidhërimin e Tij. O njeri, të kujtojmë **së pari**, se nëpër tokën të cilën po ecim, po ushqehemi, po pushojmë, po i zhvillojmë aktivitetet tona, do të jetë dëshmitare para Allahut të Lartësuar për gjynahet tona. Po kjo tokë një ditë do të ofrojë prova dhe do të dëshmojë për çdonjërin, do të flasë për çdo mëkat që është bërë në të. Do të vijë një ditë kur ajo do të shpalosë, do të zbulojë, do të publikojë dhe do të nxjerrë fshehtësitë dhe sekretet tuaja. Ka mundësi që ti, o njeri, këtë e kupton si jo serioze dhe thua: Vallë, cili është argumenti për shpalljen e provave kundër meje, se ato do të ekspozohen në Ditën e Gjykimit?!

“Kur të dridhet Toka me tronditjen e saj (të fundit), kur të nxjerrë barrët nga brendia e saj e njeriu të thotë: “Ç’po i ndodh asaj?!” Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj,...” (Zelzele 1-4).

Fjalët e Allahut: **“Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj”**, i shpjegon i Dërguari i Allahut me fjalët: **“Padyshim që tregimet (lajmet) e asaj dite janë dëshmia për çdonjërin çfarë ka vepruar në sipërfaqen e tokës, duke thënë: “E ke bërë këtë dhe këtë vepër, po në këtë ditë. Këto pra, janë rrëfimet e asaj dite.”** (hadith hasen – Tirmidhiu).

Së dyti, le të kujtojmë se melaiket shënojnë veprat e mira dhe të këqijat. Nuk mbetet asgjë pa u regjistruar dhe në ditën e gjykimit pyeten: A të kujtohet nata kur ti ishe pranë ekranit televiziv dhe shikoje kanalet që transmetonin femra të

“... Bëhu rob i Allahut në shtëpi, rob i Allahut në xhami, rob i Allahut në rrugë, rob i Allahut në punë, rob i Allahut kur njerëzit të njohin dhe kur nuk të njohin, edhe kur të jesh në vetmi pa askënd, pos Allahut. Allahu është Ai që të sheh këtu dhe atje... ”

zhveshura, seriale epsharakë, filma degjenerues? Ndoshta të kujtohet si veproje. Me siguri që ti ishe vetëm, pa askënd tjetër. Po ta dije se melaiket kanë regjistruar çdo gjë, çdo veprim tëndin, nuk do të kishe vepruar ashtu, nuk do të kaloje nga një kanal në tjetrin. Është e mundur që serialet, pjesët muzikore, filmat, lojërat, bisedat me telefon, qëndrimi i gjatë në internet, të gjitha këto e humbin besimtarin dhe besimtaren dhe e largojnë nga namazi dhe ia humbin kohën. Por mos harro se melaiket dëgjojnë dhe shënojnë veprimet e juaja dhe në Ditën e Gjykimit ato do t'i lexoni: **“Vallë, a mos kujtojnë ata se Ne nuk i dëgjojmë fjalët e tyre tinëzare dhe bisedat e tyre të fshehta? Pa dyshim, Ne dëgjojmë, ndërsa të dërguarit Tanë (engjëj) që janë pranë tyre, shënojnë.”** (Zuhruf 80).

Pas këtyre shënimeve, ç’do të ndodhë? Kur vdes njeriu, mbyllet dosja e shënimeve, kështu që me të do të takohesh. Pas daljes tënde nga varri do të vijë dosja e shënimeve të tua e regjistruar nga melaiket në dynja. Allahu i Lartësuar do ta urdhërojë njeriun që t'i lexojë shënimet e veta.

“Çdo njeriu ia kemi varur në qafë

llogarinë për punën e tij dhe Ne do t'ia paraqesim Ditën e Kiametit librin, që do ta gjejë të hapur (e do t'i themi): ***“Lexoje librin tënd! Ti mjafton sot si llogaritar kundër vetvetes!”*** (Israë 13-14).

Çast i vështirë dhe shqetësues! Njeriu qëndron i zhveshur para Krijuesit, Allahut, bashkë me të edhe dosja e shënimeve, divani i cili përmbledh të mirat dhe të këqijat. **Së treti**, le të kujtojmë se gjymtyrët e trupit, si: duart, këmbët, gjuha, sytë, veshët po edhe e tërë lëkura. Të gjitha këto, o njeri, do të dëshmojnë për ty në Ditën e Gjykimit. Do t'i zbulojnë mëkatet, krimet dhe haramet e tua dhe do t'i bëjnë publike. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Sot Ne ua mbyllim gojë të atyre...”*** (Jasin 65).

E më pas ç'do të ndodhë: ***“...Neve na flasin duart e tyre...”*** (Jasin 65)

Vallë a do të mbesë me kaq, jo: ***“...Kurse këmbët e tyre dëshmojnë për atë që punuan.”*** (Jasin 65).

Ah, ditë e rëndë dhe e vështirë do të jetë!...

Duart do të flasin e do të thonë: “O Zot, këto duar kanë blerë revistat e ndyra, cd-të me muzikë. Po këto duar kanë ndërruar kanalet satelitore. Këto duar kanë prekur trupin e femrës së huaj. Këto duar kanë përgatitur duhanin, drogën, alkoolin...” Këmbët po të njëjtën gjë do të thonë: “Edhe ne kemi ecur për në haram, nuk jemi ngritur për ta falur namazin, kemi kërcyer në klubet e natës, kemi ecur nëpër plazhe...”

Por edhe më shqetësuese do të jetë kur të flasë lëkura, e ***“Ata do t'i thonë lëkurave të veta: “Pse dëshmuat kundër nesh?”*** (Fussilet 21). Përgjigjja do të jetë: ***“Allahu, i Cili çdo sendi ia ka dhënë të folurit, na e dha edhe neve.”*** (Fussilet, 21)

Vëlla dhe motër, ndalu dhe mendo mbi këto fakte e argumente dhe askush nuk ka mundësi t'i shmanget. Mos e kalo kohën së

koti, shfrytëzoji edhe sekondat në kënaqësinë e Allahut. Të përkujtuarit e Ahiretit dhe argumentet e lartpërmendura nuk mbjellin tmerr dhe pesimizëm tek njeriu, por përkundrazi këto të dhëna hyjnore janë rregullatorë të veprimeve të njeriut në këtë botë. Kujto atë ditë, se do të ndodhë. Beso bindshëm dhe vepra, mbill të mira, se do t'i vjelësh frytet e saj në botën tjetër. Bëhu rob i Allahut, rob i cili përulet në ruku dhe në sexhde, lexon Kuran, i nënshtrohet dhe i përulet Krijuesit, Allahut. Bëhu rob i Allahut në shtëpi, rob i Allahut në xhami, rob i Allahut në rrugë, rob i Allahut në punë, rob i Allahut kur njerëzit të njohin dhe kur nuk të njohin, edhe kur të jesh në vetmi pa askënd, pos Allahut. Allahu është Ai që të sheh këtu dhe atje. Pra, i mençur është ai që bën llogari para se t'i nënshtrohet llogarisë së Allahut të Lartësuar. Atëherë merrni masat preventive për vitin e ardhshëm, që të jeni më të mobilizuar për të vepruar me kënaqësinë e Allahut të Lartësuar në kënaqësinë e Tij. Dhe në fund po e përmbylli me këto mesazhe:

- Mundohu të jesh prej bamirësve: ***“Allahu me të vërtetë i do bamirësit.”*** (Bekare 195).

- Mundohu të jesh prej të penduarve të pastruar: ***“Pa dyshim, Allahu i do ata që pendohen fort*** (për gjynahet) ***dhe ata që pastrohen.”*** (Bekare 222).

- Mundohu të jesh prej të devotshmëve: ***“Allahu, me të vërtetë, i do ata që janë të devotshëm.”*** (Ali Imran 76).

- Mundohu të jesh durimtar: ***“Allahu i do të duruarit.”*** (Ali Imran 146).

- Mundohu t'i mbështetesh vetëm Atij: ***“Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”*** (Ali Imran 159).

- Bëhu i drejtë: ***“Vërtet, Allahu i do të drejtët.”*** (Maide 42). ■



Njeriu besimtar gëzohet për fëmijën e dhuruar nga Allahu, qoftë djalë, qoftë vajzë dhe për këtë dhuratë e falënderon Allahun. E nëse Allahu ka dëshiruar dhe ka caktuar që dikush të ketë vetëm vajza, e ky me kujdes të veçantë i edukon dhe i rrit këto vajza sipas parimeve islame, atëherë ky person në Xhenet do të jetë në shoqëri me të Dërguarin salAllahu alejhi ue selem,

LINDJA E VAJZËS — HIDHËRIM APO GËZIM?!

SHKRUAN: ZEKI ÇERKEZI

Një nënë nga trevat tona, para pak kohësh u frikësua shumë, ndërsa burri u hidhërua dhe u pikëllua, edhe pse ishte koha e një gëzimi familjar. Ç'ishte ky hidhërim në këto çaste të gëzimit? Thjesht për shkaqe absurde: lindja e një vajze?! Burri injorant i ishte kërcënuar gruas me rrahje, bile edhe me divorc, nëse prapë lind vajzë!! Pasi kishte lindur prapë vajzë, si dhe herëve të kaluara, ajo kishte arsye të frikësohet nga kërcënimet e burrit. Akoma më tragjik është fakti se kemi shumë raste të ngjashme. Në të vërtetë historia e popullit tonë është plot e përplot me raste të këtilla. Situata është identike të të gjithë njerëzit injorantë, pa dallim në kohë apo në hapësirë.

Këtë çoroditje të madhe Islami e lufton me

vendosmëri. Kurani dhe Suneti na mësojnë se mashkulli dhe femra nuk kanë dallim tjetër vetëm se nga aspekti fizik. Allahu i Lartëmadhëruar në Kuranin Fisnik thotë: *“Unë nuk ia humb mundin asnjërit prej jush, mashkull qoftë apo femër.”* (Ali Imran 195). Në ajetin tjetër, Allahu thotë: *“Dhe kushdo që bën vepra të drejta e punë të mira, mashkull apo femër qoftë dhe është besimtar i vërtetë, një i tillë do të hyjë në Xhenet dhe atyre nuk do t’u bëhet padrejtësi, as sa lëvozhga e bërthamës së hurmës.”* (Nisa 124). Gjithashtu Allahu i Madhëruar thotë: *“Kush bën një vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t’i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t’u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre.”* (Nahl 97), si dhe ajeti: *“Kushdo që bën një vepër të keqe, nuk ndëshkohet veçse me një të tillë, si ajo dhe kushdo që bën*

një vepër të mirë e të drejtë, qoftë mashkull apo femër duke qenë besimtar i vërtetë, të tillët do të hyjnë në Xhenet në të cilin do t'u shërbehet (me të gjitha të mirat pa masë e) *pa kufi.*" (Gafir 40). Vërtet pas leximit me vëmendje të këtyre ajeteve Kuranore, nuk ka vend edhe për dyshimin më të vogël për barazinë e plotë të femrave në Islam, me përjashtim të specifikave të natyrës femërore.

Aq më tepër, duke u bazuar në hadithe autentike, Islami shkon edhe një hap më tutje duke treguar se prindërit në ahiret përfitojnë më shumë nga vajzat, sesa nga djemtë. Imam Muslimi përcjell në Sahihun e tij nga Enes b. Maliku, se i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *"Kush kujdeset për dy vajza derisa ta arrijnë pubertetin, do të vijë Ditën e Kiametit unë dhe ai kështu."* – dhe e bashkoi Resulullahu, salAllahu alejhi ue selem, gishtin tregues me gishtin e mesëm. (Muslimi nr. 2631). Me bashkimin e dy gishtërinjve të tij i Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem, aludon në shoqërimin e tij me këtë kategori njerëzish në Xhenet. Dijetarët fjalën 'kujdeset' e komentojnë, si kujdes fizik dhe kujdes shpirtëror. Me kujdesin fizik nënkuptohet sigurimi i ushqimit, ujit, veshmbathjes, banesës, orënditë elementare për nevoja të përditshme etj. Kurse kujdesi shpirtëror do të thotë: edukimi, arsimimi fetar (gjërat më elementare fetare, mësimi i të cilave është i detyrueshëm), urdhri në të mirë, ndalimi nga e keqja etj. Pra, kujdeset për dunjanë dhe ahiretin e tyre. Në këtë hadith ka tregues, se këtë privilegj të madh, do ta gëzojë kujdestari i mirëfilltë i vajzave dhe nuk vlen për kujdestarinë e djemve. Por tek ne për fat të keq në çastin e marrjes së lajmit se do të ketë vajzë, ndodh ai hidhërim dhe pikëllim, gjë të cilën Allahu e përshekruan në Kuran: *"Dhe kur i vjen lajmi për lindje vajze, kujtdo prej tyre i nxihet fytyra dhe mbushet përbrenda plot me hidhërim që*

zien! Fshihet prej njerëzve, për shkak të asaj të keqeje me të cilën u lajmërua (e konsideron bela, e jo dhuratë prej Allahut)." (Nahl 58-59). Jo se një njeri i tillë injorant nuk gëzohet për lindjen e vajzës, por ai bën një mëkat akoma më të rëndë: nuk pajtohet dhe nuk kënaqet me caktimin e Allahut, e Allahu i Urtë e i Gjithëfuqishëm për ne zgjedh atë më të mirën. Allahu i Lartëmadhëruar në Kuran thotë: *"Ai i dhuron vetëm (fëmijë) femra atij që do; Ai edhe i dhuron vetëm (fëmijë) meshkuj atij që do Ai. Ose Ai i dhuron të dy palët: edhe meshkuj, edhe femra, por atë që do e bën që të mbetet shterpë pa fëmijë."* (Shura 49-50).

Njeriu besimtar gëzohet për fëmijën e dhuruar nga Allahu, qoftë djalë, qoftë vajzë dhe për këtë dhuratë e falënderon Allahun. E nëse Allahu ka dëshiruar dhe ka caktuar që dikush të ketë vetëm vajza, e ky me kujdes të veçantë i edukon dhe i rrit këto vajza sipas parimeve islame, atëherë ky person në Xhenet do të jetë në shoqëri me të Dërguarin salAllahu alejhi ue selem. Çfarë sihariqi i madh! A ka shpërblim më të mirë se të jesh në Xhenet me njeriun më të dashur të Allahut?!

Ky shpërblim kaq i madh jepet nga ana e Allahut, sipas mendimit të dijetarëve, për shkak se vajzat janë më të dobëta, shpesh lihen anash nga ana e prindërve dhe duhet durim gjatë edukimit e rritjes së tyre. Dhe kështu me këto ajete dhe hadithe Islami i lufton këto paragjykime dhe stimulon e thërret në mirëkuptim dhe mirësjellje me vajza, motra, mbesa... Si rezultat i këtij kujdesi dhe edukimi është martesë e saj me një besimtar të devotshëm dhe themelimi i një familje të re nga ana e këtij çifti të devotshëm. Pra, frytet e kujdesit tënd ndaj vajzave të tua, dhe edukimi i tyre me frymën Islame janë familjet, ku jetohet në, dhe për Islam. Sa më shumë vajza, më shumë familje islame dhe rrjedhimisht, harmoni e mirëqenie në shoqëri.

Mirëpo Muhammedi salAllahu alejhi ue selem, na mëson se kujdesi dhe interesimi për vajzën nuk përfundon me martesën e saj. I Dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem, i ka vizituar shpesh vajzat e tij. Buhariu dhe Muslimi përcjellin nga Sehël b. Sadi të ketë thënë: Nuk ka pasur Aliu emër përkëledhës më të dashur, se sa të quhet Ebu Turabi (babai i pluhurit). E pyetën Sehlin: A po na tregon ngjarjen pas së cilës u quajt Aliu, Ebu Turab? Sehël b. Sadi u përgjigj: Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, shkoi në shtëpinë e Fatimes për ta vizituar. Aliu nuk ishte në shtëpi. (Në kohën e pasdrekës Aliu zakonisht rrinte në shtëpi dhe bënte gjumin e pasdrekës, të ashtuquajtur ‘kajlule’. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem, i habitur pse s’është Aliu aty e pyet vajzën e vet: “Ku e ke burrin?” Fatimja i përgjigjet babait: Ndodhi një mosmarrëveshje mes nesh dhe ai u hidhërua, kështu që nuk e bëri kajlulen tek unë. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem, i tha njërit: “Shiko ku është ai.” Pasi e kërkoi u kthye dhe tha: O i Dërguari i Allahut! Ai ishte në xhami duke fjetur. I Dërguari salAllahu alejhi ue selem, shkoi në xhami, ku e gjeti Aliun të shtrirë. Petku i sipërm i kishte rënë nga shpina dhe kishte shpinën të pluhurosur. Duke ia pastruar shpinën nga pluhuri Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, i tha: “*Ngrihu, o i pluhurosur (Ebu Turab), ngrihu, o i pluhurosur (Ebu Turab).*” (Buhariu nr. 441, Muslimi nr. 2409). Ky është vetëm një rast i vizitës dhe i interesimit të Muhamedit salAllahu alejhi ue selem, tek vajza e tij dhe sigurisht që nuk është edhe i vetmi rast. Kështu kanë vepruar edhe të gjithë sahabet e tjerë, duke marrë mësim nga mësuesi i tyre i madh Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, e sidomos Ebu Bekri dhe Omeri.

Ebu Bekri e ka vizituar shpesh vajzën e tij Aishen, duke u interesuar për jetën e saj bashkëshortore me të Dërguarin salAllahu alejhi ue selem, dhe e ka këshilluar e

ndonjëherë edhe e ka qortuar. Kështu me një rast gjatë vizitës, Ebu Bekri e gjen Aishen duke iu drejtuar Muhamedit salAllahu alejhi ue selem, me zë të ngritur. Babai e qorton të bijën, se si ka mundësi që me atë zë të lartë t’i drejtohet Pejgamberit salAllahu alejhi ue selem, e kjo fshihet prapa burrit të saj Muhamedit salAllahu alejhi ue selem. Një ditë tjetër gjatë vizitës Ebu Bekri e gjen Dhëndrin e tij, salAllahu alejhi ue selem, dhe Aishen të buzëqeshur plot hare duke biseduar dhe iu drejtua atyre me këto fjalë: “Ashtu si më hidhëruat atë ditë, ashtu më bëni që edhe unë të qesh bashkë me ju tani”.

Buhariu dhe Muslimi përcjellin nga Aishja radijAllahu anha: Një ditë më erdhi në shtëpi një grua me dy vajzat e saj dhe lypte. Nuk kisha në shtëpi asgjë përveç një kokërr hurme. Ia dhashë atë kokërr dhe ajo e ndau atë nga një gjysmë për secilën vajzë dhe ajo për vete nuk hëngri asgjë. Kur erdhi i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, i tregova se ç’kishte ndodhur në shtëpi, e ai tha: “*Kujt i është caktuar të ketë vetëm vajza, e ai kujdeset, i edukon, ka mirësjellje dhe mirëkuptim ndaj tyre, ato do t’i jenë mburojë prej zjarrit të xhehenemit*”. (Buhariu nr. 1418, Muslimi nr. 2629)

Nga e gjithë kjo që u tha nënkuptohet se besimtari duhet të gëzohet njësoj, si për lindjen e djalit, ashtu edhe për lindjen e vajzës. Hidhërimi dhe pikëllimi me rastin e lindjes së vajzës është i ndaluar rreptësisht, përkundrazi me rastin e edukimit me frymë islame, prindërit do ta shoqërojnë të Dërguarin salAllahu alejhi ue selem, në Xhenet, dhe ato do të jenë perde për prindërit nga zjarri i Xhehenemit.

E lusim Allahun e Madhërisëm të na dhurojë fëmijë të hairit, të na furnizojë me dituri dhe durim gjatë edukimit të tyre dhe e lusim Allahun, që të na i bëjë familjet të devotshme dhe të çiltra, me edukatë të pastër islame. ■

LIGJI NDËRKOMBËTAR PËR FËMIJËT VS. FAMILJA MUSLIMANE



Ky ligj me kushtet dhe klauzolat që përfshihen aty bie ndesh me Sheriatin. Në këtë artikull do të shpalosen aspektet që e kundërshtojnë Sheriatin, bazuar në diskutimet e zhvilluara në konferencën e IICWC.

(pjesa e parë)

NGA UEFA SADAVI

Komiteti Islam Ndërkombëtar për Gruan dhe Fëmijën (The International Islamic Committee for the Woman and Child (IICWC)) ka mbajtur një konferencë, më 15 prill 2008, për të diskutuar draftin e ligjit për fëmijët në vazhden e debateve të nxehta që po zhvillohen në Egjipt. Disa besojnë se kjo është fryt i një konspiracioni të përgatitur mirë me vite të tëra kundër botës islame.

Për fat të keq ky ligj i dyshimtë është ratifikuar nga parlamenti egjiptian, pavarësisht nga vërejtjet dhe refuzimet e prindërve dhe kujdestarëve. Kjo është shenjë e qartë që tregon se një ligj i tillë do të ratifikohet së shpejti edhe në vende të tjera muslimane.

Marrëveshjet e diskutueshme

Në fillim zonjusha **Kamilia Helmy**,

kryetare e IICWC, sqaroi fazat për nënshkrimin dhe zbatimin e një numri marrëveshjesh, të cilat janë mjaft të diskutueshme për sa i përket botës islame. Këto faza janë:

Përpjekja për t'i bindur vendet arabe dhe islame që të nënshkruajnë këto marrëveshje me ca kufizime në disa pika.

Më pas vjen nënshkrimi i vërtetë.

Menjëherë pason trysnia nga vendet e huaja që të largohen këto kufizime duke u arsyetuar se marrëveshja u lejon shteteve që të zbatojnë këto pika sipas legjislacioneve vendëse.

Pasi të hiqen këto kushte, thirrja drejtohet nga ndryshimi i ligjeve vendëse, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara ndërkombëtare.

Ky është një cikël nëpër të cilën kalojnë vendet muslimane pothuajse çdo herë, kur kanë të bëjnë me secilën marrëveshje ndërkombëtare.

Detyrimi ligjor

Jahja Said Kadi, jurist në Gjykatën e Lartë të Apelit në Egjipt, ka thënë se marrëveshjet ndërkombëtare kanë tri karakteristika:

Krijojnë legjislacion të ri për vendet që i nënshkruajnë ato,

I detyrojnë shtetet që t'i përmbushin disa detyrime e më pas të paraqesin raportet e tyre në OKB, e cila më pas vlerëson sesa ky shtet është i bindur ndaj këtyre marrëveshjeve,

Nuk janë subjekt i ndryshimit me amendamente, në dallim nga legjislacioni vendës, të cilin deputetët e parlamentit mund ta përmirësojnë dhe ta ndryshojnë.

Më tej Kadi përmend faktin se ligjet që kanë të bëjnë me gratë dhe fëmijët, si dhe marrëveshjet e tjera mbi jo-diskriminimin janë nënshkruar nga të gjitha shtetet, përveç një numri të vogël shtetesh, si Somalia dhe SHBA-të, e cila e ka refuzuar një gjë të tillë. Ndërsa Egjipti dhe të gjitha vendet e tjera arabe i kanë nënshkruar dhe kanë filluar të nxjerrin amendamentet kushtetuese sipas këtyre marrëveshjeve. Kadi tregon se ligjet vendëse bëjnë pjesë në dy grupe, për sa i përket marrëveshjeve ndërkombëtare. Disa ligje i trajtojnë ato si legjislacion më të lartë, ndërsa të tjerat mundohen, që këtyre marrëveshjeve t'ua bashkëngjisin legjislacionin e brendshëm, siç është rasti me ligjin e Egjiptit.

Elasticiteti

Helmy sqaroi rolin e madh të terminologjisë në këto dokumente. Për shembull, në rast se prindërit e refuzojnë të drejtën e tyre që t'i ndëshkojnë fëmijët e tyre për disa gabime, a do të konsiderohej ky si një "akt negativ që paraqet kërcënim psikologjik"?

A konsiderohet synetimi i fëmijëve "kërcënim ndaj sigurisë fizike të fëmijëve"? Deri ku ka arritur Sheriati Islam, që i ka

“Ligjet që kanë të bëjnë me gratë dhe fëmijët, si dhe marrëveshjet e tjera mbi jo-diskriminimin janë nënshkruar nga të gjitha shtetet, përveç një numri të vogël shtetesh, si Somalia dhe SHBA-të...”

dhënë të drejtën prindërve t'i rrisin dhe t'i edukojnë fëmijët e tyre me metoda disiplinore (ndëshkimi i kufizuar si njëra nga këto metoda)?

Abdullah b. Amr b. Asi përcjell se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Urdhëroni fëmijët tuaj të falin namaz kur janë 7 vjeç, dhe goditini ata nëse refuzojnë të falin namazin kur janë 10 vjeç. Dhe ndani ata nga shtrati, në mënyrë që secili fëmijë të flejë veçmas.”* (Ebu Davudi).

Kjo konferencë kritikoi të gjitha procedurat e propozuara të sigurisë të ndërmarra duke pasur si qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga “rreziku”, fjalë kjo që nuk është e përkufizuar qartë dhe saktë. A konsiderohet edukimi me ndëshkim, që prindërit zbatojnë, kërcënim ndaj “sigurisë së fëmijës”? Përkufizimi i fjalës “rrezik ndaj fëmijëve” është tejet dredhues dhe elastik, duke e bërë atë subjekt të interpretimeve personale dhe të keqkuptimeve.

Të drejtat seksuale

Përveç kësaj Helmy iu referua neneve të ligjit të propozuar për fëmijët, si një “provokim dhe kundërshtim ndaj Sheriatit dhe fitres (natyrshmërisë njerëzore)”. Ligji në fjalë nuk e lejon martesën e personave nën 18 vjet, si rrjedhojë regjistrimi i martesave që bëhen nën këtë moshë është i

kundërligjshëm. Në anën tjetër, ligji bën thirrje për të drejtat seksuale të adoleshentëve dhe të drejtat e tyre për të pasur pasardhës. Po ashtu me anë të këtij ligji iu jepen të drejta nënave beqare (adoleshente) e të pamartuara. Madje disa klauzola kërkojnë që të ketë barazi të plotë mes meshkujve dhe femrave, pa marrë parasysh dallimet biologjike. Disa e shohin këtë si hapje e rrugës për ndryshimet në ligjin islam të trashëgimisë! Gjithashtu fëmijëve iu jepet gjithçka që dëshirojnë për të drejtat e tyre seksuale dhe të drejtat e tyre për të pasur pasardhës, pa ndonjë kufizim apo moral dhe detyrë fetare. Me këtë fëmija fiton të drejta tej mase. Allahu i Madhërishtëm thotë në Kuran: **“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse me të vërtetë është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”** (El Isra, 17:32). Veç kësaj shejh Mehdi përkujton thënien e Muhamedit salAllahu alejhi ue selem *“O ju të rinj, nëse keni mundësi për martesë, atëherë martohuni sepse kjo mundëson uljen e shikimit dhe mbron organet e turpshme. E kush nuk ka mundësi, atëherë le të agjërojë, sepse agjërimi e zvogëlon epshin seksual.”* (Buhariu). Po ashtu Kurani iu drejtohet kujdestarëve, ku thuhet: **“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit)...”** (Nur, 32), pra, urdhër nga Zoti që të martojnë të pamartuarit, pasi martesë është nevojë natyrore.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje, që kërkon martesat të bëhen jo nën moshën 18 vjeçare, mundëson kryerjen e marrëdhënieve seksuale nëpërmjet “seksit të sigurt” pa marrë parasysh moshën e kryerësve.

Zvogëlimi i rolit të prindërve

Konferenca e IICWC bëri thirrje që të shqyrtohen me kujdes klauzolat e ligjeve të propozuara, të cilat cenojnë të drejtat e prindërve për t'i edukuar fëmijët e tyre, si dhe ato që e detyrojnë zvogëlimin e rolit të

ndjeshëm të prindërve. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Burri është kujdestar mbi familjen e tij (kujdeset për mirëqenien e tyre fizike, shpirtërore dhe morale) dhe për këtë ai do të merret në përgjegjësi. Gruaja është kujdestare mbi shtëpinë e burrit dhe fëmijët, dhe për këtë ajo do të merret në përgjegjësi.”* (Muslimi). Po ashtu në një hadith tjetër Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Asgjë më të mirë nuk mund t'i dhurojë babai djalit të vet, sesa mirësjelljen.”* (Tirmidhiu). Gjithashtu ligji krijon hapësirë për ndërhyrjen e qeverisë në jetën dhe çështjet private të familjes. Kjo gjë mbjell farën e konfliktit dhe ndasisë mes fëmijëve dhe prindërve, duke e prishur kështu imazhin dhe rolin e prindërve, përderisa mëshira dhe dhembshuria duhet të jenë baza mbi të cilën ndërtohet familja. Bazë e shëndoshë për zhvillimin psikologjik të fëmijëve është edukata që ata marrin nga prindërit e tyre, siç thotë Allahu në Kuran: **“Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahun përulës e respektues dhe thuaj: “Zoti im! mëshiroji ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël”.** (Isra, 17:24).

(autorja është shkrimtare dhe gazetare egjiptiane)

Marrë nga:

http://www.islamonline.net/servlet/Satellite?cidw1213871172562&pagename=wZone-English-Living_Shariah%2FLSELayout

(pjesa e dytë)

Muhamed Muhtar Muhamed Mehdi

Duke u nisur nga detyrimi për dhënien e këshillës dhe shpërndarjen e saj tek muslimanët, dhe duke marrë parasysh draftin e propozuar në parlamentin e Egjiptit për ligjin e fëmijëve, ne i

përkujtojmë vëllezërit tonë të ndershëm (që kemi besim në fenë dhe integritetin e tyre), si dhe të tjerëve që përkujdesen për të ardhmen e umetit musliman, dhe vlerave të tyre, se ky ligj i propozuar - siç thuhet në nenin e tretë të tij, paragrafi A, ku si pikë referuese merret “rregullorja e marrëveshjes ndërkombëtare rreth të drejtave të fëmijëve dhe të drejtave të tjera ndërkombëtare që lidhen me to, e që janë në fuqi në Egjipt” është në kundërshtim të hapur ndaj Sheriatit Islam.

Është më se e qartë se kushtet që Perëndimi i ka futur në këtë dokument, që janë nënshkruar nga Egjipti në bazë të vullnetit të mirë, bartin me vete koncepte perëndimore rreth lirisë, barazisë, dhe të drejtave njerëzore. Kjo është e dukshme në versionin anglisht të këtyre të drejtave, që janë të pranuar ndërkombëtarisht. Gjithashtu ky ligj ka fuqi “ligjësuere, urdhëruese, detyruese dhe hyn vetvetiu në fuqi” fakt ky i njohur prej të drejtës ndërkombëtare. Frazat e përkohshme që i janë shtuar përkthimit në arabisht, sikurse fraza “pa e kundërshtuar Sheriatin Islam” nuk përmbajnë kurrfarë vlere. Pas ratifikimit të këtij projekti nga ana e parlamentit, pason një trysni e fortë që të largohen këto kufizime, sikurse ka ndodhur në të kaluarën me disa marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e grave.

Prandaj po i përmendim shkurtimisht klauzolat më të rrezikshme të këtij drafti, i cili kundërshton vlerat themelore Islame:

E para: Zgjatja e fëmijërisë deri në moshën 18 vjeçare është në kundërshtim me rregullat e Sheriatit, i cili e përcakton pubertetin si moshë e detyrimeve dhe llogaridhënies. Kjo bazohet në hadithin e Pejgamberit salAllahu alejhi ue sem: “*Lapsi nuk shënon për tri... për fëmijën derisa të arrij moshën e pubertetit*”. Puberteti është një shenjë dalluese, e cila shfaqet tek djemtë,

“...Dihet se askush nuk mund të jetë më i mëshirshëm për fëmijët e vet, sesa prindërit e tyre...”

jo më vonë se në moshën 15 vjeçare. Rrjedhimisht, nëse fëmija e arrin këtë moshë, atëherë mbi të bien detyrimet edhe nëse nuk shfaq shenja të pubertetit. Sa i përket vajzave, puberteti i tyre fillon edhe më herët se ai i djemve. Rreziku i zgjatjes së fëmijërisë deri në moshën 18 vjeçare qëndron në dy aspekte: **e para**, ulja e dënimeve për krimet e kryera nga personat nën moshën 18 vjeçare, madje edhe nëse krimet kërkojnë dënim me vdekje sikurse përmendet në nenin 112. Kjo nxit dhe stimulon krimin dhe formimin e bandave të adoleshentëve për të kryer vrasje, plaçkitje, dhunime dhe akte të tjera dhune gjithmonë duke qenë të sigurt nga ndëshkimet e rrepta. **E dyta**, ndalimi për të regjistruar martesën nën moshën 18 vjeçare, edhe nëse kujdestari i saj dëshiron ta mbrojë atë nga rënia në mëkat. Ndërsa zgjedhja për t’u martuar me vajzën e re apo djalin e ri është detyrim i Sheriatit, sipas ajetit kuranor: “*Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit)...*” (Nur 32). Përveç kësaj, nuk i lejohet asnjë shteti, i cili ka për fe Islamin, të kufizojë apo të ndalojë atë që feja Islame e lejon e posaçërisht, nëse kemi të bëjmë me një çështje që parandalon devijimin dhe e mbron dëlirësinë.

E dyta: Mes të tjerash në nenin 3, paragrafi B, thuhet “sigurimi i barazisë aktuale mes fëmijëve dhe parandalimi i diskriminimit ndaj tyre për shkak të gjinisë apo fesë.” Kjo detyron barazinë midis meshkujve dhe femrave, muslimanëve dhe jomuslimanëve në çështjet e trashëgimisë, ide e cila bie ndesh me tekstet Kuranore dhe

traditën e profetit Muhamed salAllahu alejhi ue selem.

E treta: Nxit fëmijët të paraqesin ankesat kundër prindërve të tyre. Vetëm ndaluni dhe analizoni këtë skenar, kur prindërit dëshirojnë të përmirësojnë dukuri të devijimit tek fëmijët e tyre, siç është rasti kur fëmijët që janë 10 vjeçar refuzojnë të falin namaz, gjë për të cilën Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, ka urdhëruar kujdestarin e fëmijës ta rrahë atë lehtë (jo dhunshëm). Dihet se askush nuk mund të jetë më i mëshirshëm për fëmijët e vet, sesa prindërit e tyre.

Ky rrezik demonstrohet në nenin 97, të paragrafit 4 ku lexojmë: “Me pranimin e ankesave prej fëmijëve, departamenti për shpëtimin e fëmijëve ka autoritet të kërkojë të bëhen hetime dhe autorizim nga policia juridike për kryerjen e detyrave të tyre.” Ky paragraf nuk e përjashton aktin reformues, që ndërmarrin prindërit, porse shkon përtej, duke aplikuar dënimin mbi ata që shpërdorin fëmijët dhe fqinjët, që kanë qenë në dijeni për këtë, por nuk e kanë lajmëruar rastin. Kjo d.m.th. përgjim dhe spiunim i njerëzve në çështjet e tyre private dhe në shtëpitë e tyre. Gjithashtu kjo është një ndërhyrje në çështjet dhe godinën familjare, si dhe mbjell përçarjen në marrëdhëniet shoqërore, megjithëse familja është shtylla e vetme, ku arrihet edukimi i mirëfilltë i fëmijëve.

E katërta: Emërtimi i fëmijëve. Në paragrafin e fundit të nenit 15 thuhet me sa vijon: “Nëna ka të drejtë ta paraqesë dhe ta regjistrojë fëmijën e saj zyrtarisht dhe të marrë certifikatën e lindjes, ku figuron emri i saj si nënë.” Kjo vetëm se nxit përhapjen e marrëdhënieve jashtëmartesore, që çon në shtimin e fëmijëve të rrugëve dhe të fëmijëve prindërit e të cilëve nuk iu dihen. Për më tepër marrëveshja ndërkombëtare rreth të drejtave të fëmijëve, që është

lëshuar nga OKB-ja në vitin 1989, si dhe “A World Fit for Children (Një botë e përshtatshme për fëmijët)” që është lëshuar në vitin 2002, e cila sqaron të parën dhe mundëson hyrjen e saj në fuqi, të dy këto dokumente bëjnë thirrje për shërbimet riprodhuese të fëmijëve dhe të adoleshentëve, përfshirë këtu edhe edukatën seksuale, dispozitat për përdorimin e kondomëve, përkujdesje për adoleshentet shtatzëna dhe ligjësimin e abortimeve, nëse vajza e dëshiron një gjë të tillë. Të gjitha këto parashihen për vitin 2015, siç vërtetohet në këto marrëveshje. Njëpërmjet këtyre ligjeve mundësohet përhapja e marrëdhënieve jashtëmartesore dhe e fëmijëve jo legjitim. Këto të drejta bëjnë thirrje për barazi gjinore, që përfshin edhe ligjësimin e homoseksualizimit, duke e pranuar atë dhe duke iu dhënë të drejta homoseksualëve, ashtu siç pasqyrohet në mënyrën e jetesës perëndimore, e cila nuk përkon aspak me shoqërinë tonë Islame.

Prandaj duhet të marrim një qëndrim të prerë në lidhje me fenë tonë, vlerat që burojnë prej saj dhe identitetin islam, para se të humbim në humnerën e perëndimit dhe të nënshtrimit. T’i përforcojmë djemtë dhe bijat tona kundër kësaj vale fatkeqe, e cila shkatërron parimet tona të personalitetit të pavarur. Allahu është qëllimi jonë dhe vetëm me Allahun qëndron e tërë mbrojtja dhe suksesi.

(autori është kryetar i Komitetit të dijetarëve të shoqatës së Sheriatit, profesor në universitetin e Az’harit dhe anëtar i kompleksit për kërkime Islame.) ■

Marrë nga:

http://www.islamonline.net/servlet/Satellite?e?cwArticle_C&cidw1213871184109&pagenamewZone-English-Living_Shariah%2FLSELayout

KOHA, BEGATI APO NDËSHKIM

(KOMENT I SURES EL ASR)

Bismilahi Rahmani Rahim

1.) Uel Asr. 2.) Innel insane lefi husr. 3.) Il'lel lehdine amenu ue amilus salihati ue teuasau bil hakki ue teuasau bis sabër.

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit

1.) Pasha kohën. 2.) Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. 3.) Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që e këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.

PËRGATITI: BASHKIM BAJRAMI

Bismilahi Rahmani Rahim

1.) Uel Asr. 2.) Innel insane lefi husr. 3.) Il'lel lehdine amenu ue amilus salihati ue teuasau bil hakki ue teuasau bis sabër.

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit

1.) Pasha kohën. 2.) Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. 3.) Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që e këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.

Kjo sure ka tre ajete dhe është sure mekase. Imam Shafiu thotë: "Nëse do të meditonin njerëzit rreth kësaj sureje do t'iu mjaftonte atyre". Taberaniu na përcjell në

librin e tij, se Abdullah b. Husejn Daremiu ka thënë se kur takoheshin dy shokë të Pejgamberit salaAllahu alejhi ue selem nuk ndaheshin përderisa ia lexonin njëri-tjetrit këtë sure, pastaj jepnin selam. Ky veprim na tregon për madhësinë dhe vlerën e kësaj sure, e cila përmban porosi ku bëhet fjalë për iman, vërtetësi, durim, humbje, vepra të mira etj.

Ibnul Kajimi thotë se kjo sure përmban katër çështje:

- Diturinë dhe njohjen e së Vërtetës,
- Të punuarit me të,
- Thirrja e të tjerëve në të Vërtetën,
- Durimi.

Pasha kohën (Uel Asr).

Ibn Kethiri thotë: Asr është koha kur ndodhin lëvizjet e njerëzve, si e mira ashtu edhe e keqja.

Ibn Abasi thotë: Asr është orë prej orëve të ditës, koha para se të perëndojë dielli.

Ibn Kajimi thotë: Asr është koha e parë pas akshamit, ora fundit kur errësohet dita, namazi i ikindisë.

Raziu thotë: Asr është koha kur ka gëzim e hidhërim, sëmundje e shërim, pasuri e varfëri.

Mirëpo shumica e dijetareve janë të një mendimi, se **Asr** është koha në përgjithësi, siç thotë imam Sheukani: “Është betuar Allahu i Lartësuar në kohën, për arsye se ka ndodhi të shumta: ndërrimi i ditës dhe i natës, errësira, drita etj. E gjithë kjo aludon për ekzistimin e Tij, gjë që e bën detyrim besimin në Te.

Imam Buhariu përcjell nga Abdullah b. Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me te, se Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, ka thënë: “*Ndaj dy të mirave, shumë njerëz bëhen mendjelehtë: shëndeti dhe koha e lirë.*” Ibnul Kajimi thotë: “Humbja e kohës është më e madhe se vdekja, sepse humbja e kohës e largon njeriun nga Allahu dhe nga bota tjetër, ndërsa vdekja të largon vetëm nga kjo botë”.

Jeta është rrugë dhe kohë e caktuar, nëpër të cilën ecën fati i njeriut. Pra, koha është vetë jeta e njeriut. Përse njeriu duhet të jetë kaq i shkujdesur? Ai që e kalon kohën duke u munduar të kënaqë vetëm egon e tij bëhet rob i dëshirave dhe tekave të tij dhe prapëseprapë nuk e arrin këtë gjendje. Kështu afati i jetës së tij kalon me një rini të humbur e pleqëri të mjerë. Çfarë fundi është ky? Ai nuk kënaq, as veten, as Krijuesin e tij.

Nëse dikush prej krijesave të Allahut duhet të kujdeset më së shumti për kohën e tij, ai është muslimani, sepse për kohën do të jepet llogari. Si jemi ne në raport me kohën. Duke e ditur se jemi ne përfundim të vitit kalendarik, sa njerëz dhe si e kanë llogaritur ata në raport me Allahun, sekondat, minutat, orët, ditët, javët, muajt e kaluar. Po ti që ke kaluar me vite të tëra si i ke këto vite në raport me Allahun. Për 60 vjet jete, sa kohë i kushtove Zotit tënd. Apo gjithë kohën e kalove në humbje e dëfrim. Ku ishe kur thirrej ezani, kur kërkonin nevojtarët ndihmën tende, kur jetimët qanin, kur prindërit kërkonin një gotë ujë, kur vriteshin njerëzit e pafajshëm sa dhimbje ke ndjerë.

Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.

Vërtetë njeriu është në humbje. Nëse njeriu vdes duke mos qenë besimtar, duke mos i kryer detyrimet që ka caktuar Allahu për njerëzit, pa dyshim se ai është në humbje të sigurt. Atij nuk do t'i bëjë dobi, as pasuria, as familja, as pozita e tij shoqërore, përveç atij që ka iman, besim të drejtë dhe vepra të pranuar. Pastaj Allahu na njofton për ata që janë të shpëtuar.

Me përjashtim të atyre që besuan...

Ata që kanë dituri, dhe e njohin të vërtetën janë ata që besojnë, dhe e dinë se Allahu ekziston në të vërtetë, premtimi i Tij është i vërtetë dhe Pejgamberi i Tij është i vërtetë, takimi me Atë është i vërtetë, melaiket janë të vërtetë, pejgamberët janë të vërtetë, xheneti është i vërtetë si dhe xhehenemi është i vërtetë, dhe pastaj vepron me besimin e tij.

Që bënë vepra të mira...

Ata që i kryejnë detyrimet e caktuara nga ana e Allahut dhe largohen nga ndalesat e Tij, siç thotë Imam Taberiu "Ata që kanë kryer farzet dhe janë larguar nga haramet". Nuk mjafton vetëm besimi pa vepra. Shtrohet pyetja se sa njeriu jashtë

farzeve kryen dhe shton vepra të mira, sa fal ai namaz me xhemat, sa fal namaze nafile, sa lexon ai Kuran, sa jep lëmoshë, sa e viziton farefisën, sa i viziton të sëmurit, sa herë viziton varrezat, sa i ndihmon bonjakët...

Që porosisin njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës...

Pasi ta kuptojë të vërtetën dhe të punojë me të, besimtarit i duhet që t'i thërrasë edhe të tjerët në të, dhe ta kryejë detyrimin fetar, sepse si umet jemi dalluar e të privilegjuar që thërrasim dhe urdhërojmë në të mirë dhe ndalojmë nga e keqja, ashtu siç thotë Allahu në Kuran: ***"Ju jeni populli më i dobishëm i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni në të mirë dhe ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni Allahun"***. Ali Imran 110. Muslimani duhet ta pyesë veten e vet brenda këtij viti, sa vetë i ka urdhëruar në të mira si në namaz, agjërim, në besim të drejtë, në bamirësi, dhe sa vepra ka ndaluar, si alkoolin, prostitucionin, vjedhjen, gënjeshtren e shumë dukuri të tjera negative, që janë përhapur në shoqërinë tonë.

Dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.

Këshilla e fundit është që të jemi të durueshëm, dhe t'i porosisim të tjerët të jenë të durueshëm, sepse siç dihet mbasi t'i urdhërojmë të tjerët në bamirësi, dhe t'i ndalojmë nga veprat e këqija hasim në kundërshtime nga pala tjetër, e kjo porosi Kuranore na mëson se si të veprojmë në këto situata. Durimi ndahet në tri lloje:

- a. durim për të bërë adhurim,
- b. durim ndaj mëkateve, si dhe
- c. durim gjatë fatkeqësive.

Allahu i do durimtarët dhe i shpërblen pa kufi, ashtu siç thotë Allahu në librin e Tij fisnik: ***"Allahu është me durimtarët."*** Bekare 249. ■

I NXEHTI DHE I FTOHTI I XHEHENEMIT

Na përcillet nga Ebu Hurejre, Allahu goftë i kënaqur me të, se i Dërguari, salallahu aeji ue selem, ka thënë:
“Zjarri iu ankua Allahut duke i thënë: “O Zot, jam duke u ngrënë ndër vete (po zihem me veten)”. Atëherë Allahu i lejoi që ta lirojë veten dy herë në vit, njëherë në verë e tjetrin në dimër. Prandaj nxehtësinë më të madhe që e ndjeni në verë është shfryrje (frymënxjerrje) e zjarrit të xhehenemit, kurse të ftohtin e madh që e ndjeni në dimër është nga shfryrja (frymënxjerrja) e të ftohtit të xhehenemit”.

Shkruan: LULZIM SUSURI

Këtë hadith e përcjell Ebu Hurejre, të cilin e shënon Imam Buhariu në Sahihun e tij, nr. 537, 3260, Imam Muslimi, nr. 1400, 1401, 1402 etj., ku nga shënimi i këtyre dy dijetarëve nëpër librat e tyre e kuptojmë pa hezitim se hadithi është i saktë.

Komenti i hadithit:

Në këtë hadith përmendet një ndër çështjet e fshehta (**gajb**), të cilat askush nuk i di ndërsa janë të përcjella nga i Dërguari, salallahu aeji ue selem. Kjo nuk nënkupton se Profeti i Zotit i di fshehtësitë, por një lajm të tillë ai e mori nga vetë Allahu i Lartësuar, që është Krijues i çdo sendi dhe çdo gjë ndodh vetëm me urdhrin, diturinë dhe vullnetin e Tij.

Nuk ka dyshim se i nxehti dhe i ftohti janë krijime të Allahut, të cilat i krijoi me qëllime të caktuara. Ndodh që prej tyre të ketë dobi, goftë njeriu apo edhe krijesat e tjera, por

ndodh që të jetë edhe e kundërta, pra, ndonjëherë prej tyre ka edhe dëme, kjo varet nga dëshira dhe vullneti i vetë Krijuesit të tyre, Allahut të Lartësuar. Allahu i përdor ato edhe si dënim për popujt zullumqarë në këtë botë dhe në botën tjetër. Të gjithë e dimë se prej dënimeve kryesore në xhehenem është ai me zjarr. Por duhet ta kemi parasysh se dënimi i botës tjetër nuk është vetëm ai dhe të mos ketë tjetër. Pasi në këtë botë dënimet janë të llojllojshme atëherë një gjë e tillë është edhe në botën tjetër, duke e pasur parasysh së bota tjetër apo më saktësisht xhehenemi është krijuar posaçërisht për dënime.

Nga hadithi i lartpërmendur kuptojmë se ndër dënimet kryesore në botën tjetër janë nxehtësia dhe i ftohti i madh. Po ashtu ndër problemet kryesore të njerëzve në dunja nga të cilat ankohen njerëzit janë këto dy fenomene natyrore, i nxehti dhe i ftohti, ku shpeshherë dëgjon njerëz, duke u ankuar nga temperaturat e larta në verë dhe po të njëjtit njerëz ankohen nga temperaturat e ulëta në

dimër, e në anën tjetër rrallë herë rastis të dëgjosh njerëz, të cilët ankohen nga kushtet atmosferike në pranverë apo në vjeshtë.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“Zjarri iu ankua Allahut duke i thënë...”*

Nga fjala “zjarr” kuptojmë se me të është për qëllim Xhehenemi, e jo vetëm zjarr i tij, mirëpo në hadithe shpesh përmendet zjarri dhe me të kuptohet Xhehenemi për dy shkaqe kryesore: 1- zakonisht shumica e llojeve të dënimeve janë me origjinë nga zjarri. 2- zjarri është një ndër dënimet më të dhimbshme i përcaktuar për kategorinë më të keqe të njerëzve, në të cilën futen qafirët, siç është rasti i faraonit dhe familjes së tij, të cilën Allahu e përmend në Kuran.

Në këtë pjesë të hadithit vërehet qartë se xhehenemi i foli Allahut me gjuhën e të shprehurit, i folur ky i vërtetë. Ky është besim dhe bindje i Ehli Sunetit i bazuar në argumentet e Kuranit dhe Traditës Profetike. Pati njerëz të cilët menduan se kjo bisedë mes Allahut dhe Xhehenemit është vetëm një tregim alegorik nga Pejgamberi, salallahu alejhi ue selem, i kësaj bisede. Sipas tyre xhehenemi nuk mund të flasë me gjuhën e folur, por një gjë e tillë ishte kuptuar nga gjendja e tij e vështirë. Por siç thamë ky mendim nuk qëndron aspak, as nga aspekti i argumenteve, as nga ai i logjikës. Argumentet janë të qarta se xhehenemi foli, kurse logjika e pranon një gjë të tillë duke thënë se Allahu siç ia mundësoi njeriut të flasë, pasi ai nuk fliste; ashtu ia mundëson kujt të dojë që të flasë, e sa e sa raste kemi nëpërmjet të cilave vërtetohet, se gjërat qofshin ato të gjalla apo të ngurta kanë folur me lejen e Allahut, Krijuesit të tyre.





“...Ndoshta për këtë shkak vërejmë edhe nxehjen globale, si dhe dimrat me acar të madh nëpër botë sidomos në botën joislame, ku çdo vit ndodhin lloj-lloj fatkeqësish të shumta natyrore...”

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“O Zot, jam duke u ngrënë ndër vete (po zihem me veten)”*

Kjo ankesë e xhehenemit në mënyrë të qartë na tregon rrezikun dhe dënimin e dhimbshëm, të cilin Zoti e krijoi për mëkatarët, Allahu na ruajt prej tij. Dënim ky aq i madh sa edhe vetë xhehenemi pati vështirësi ta durojë një gjendje të tillë, pra, si të ngrohtin ashtu edhe të ftohtin.

Ka pasur disa mendime të dijetarëve, se si zjarri ishte duke e ngrënë veten e tij apo si zihej me veten, mirëpo të themi të drejtën asnjëri prej tyre nuk e mbështet mendimin e tij në ndonjë argument të fuqishëm, sa t'i nënshtrohemi atij plotësisht. Mendimi i përmendur më shumë dhe më i përhapur është ai se i nxehti dhe i ftohti i madh i xhehenemit gjithmonë shtohet dhe ripërtërihet, kurse ai i vjetri nuk ndalet, nuk pakësohet e as zhduket, por vazhdon të jetë i tillë vetëm se i shtohen edhe më tepër gradët plus apo minus sipas nevojës. Allahu e di më së miri!

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“Atëherë Allahu i lejoi që ta lirojë veten dy herë në vit, njëherë në verë e tjetrin në dimër.”*

Këtu do të ndalemi në një çështje të vetme, ajo është se besimi i pastër i muslimanëve është se xheneti dhe xhehenemi janë dy krijesa të Allahut, të krijuara, të cilat Zotit i ka krijuar atëherë kur krijoi çdo gjë. Ky është mendim i saktë dhe mendimi i vetëm i bazuar në argumente fetare. Nuk qëndron aspak mendimi, se xheneti dhe xhehenemi nuk janë krijuar dhe se ato do të krijohen pasi Allahu ta shkatërrojë këtë botë Ditën e Kiametit.

Fjala e të Dërguarit, salallahu alejhi ue selem: *“Prandaj nxehtësinë më të madhe që e ndjeni në verë është shfryrje (frymënxjerrje) e zjarrit të xhehenemit, kurse të ftohtin e madh që e ndjeni në dimër është nga shfryrja (frymënxjerrja) e të ftohtit të xhehenemit”.*

Nga kjo pjesë e hadithit kuptojmë se i nxehti dhe i ftohti janë pjesë e xhehenemit, pra, ato dalin nga xhehenemi. Disa dijetarë mendojnë se i tërë i nxehti veror dhe i ftohti dimëror janë të gjithë me prejardhje nga xhehenemi. Ndërsa disa të tjerë thonë se vetëm i nxehti dhe i ftohti i madh janë nga xhehenemi, kurse ai normal nga të cilët njeriu nuk ndjen vuajtje nuk janë shfryrje e xhehenemit. Këta dijetarë e bazojnë mendimin e tyre në këtë pjesë të fundit të hadithit në të cilin i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, përmend se i nxehti dhe i ftohti i madh që ndjejmë është nga xhehenemi. Allahu e di më së miri!

Lind pyetja: Si ndodhë kjo shfryrje apo kjo frymënxjerrje e xhehenemit?

Përgjigja është e thjeshtë, bile ajo është e cekur po në këtë hadith, pra, Allahu ia mundëson xhehenemit dy herë në vit që të shfryjë i lirë, pra, një herë në verë e herën tjetër në dimër. Gjithashtu kuptohet se nuk ndodh që në verë xhehenemi të lirojë të ftohtin e tij, kurse në dimër të çlirojë të nxehtin, por që të dy frymënxjerrjet i përshtaten stinës në të cilën është bota.

S’ka dyshim se njerëzit sado që të bëjnë më shumë mëkate, Allahu aq më tepër edhe e shton të nxehtin dhe të ftohtin e xhehenemit, ku edhe ndoshta për këtë shkak lirohet ky i nxehtë në verë dhe i ftohti në dimër, aq shumë sa njerëzit vuajnë që në dunja, para vuajtjeve të tyre që do të pësojnë në ahiret. Ndoshta për këtë shkak vërejmë edhe nxehtjen globale, si dhe dimrat me acar të madh nëpër botë sidomos në botën joislame, ku çdo vit ndodhin lloj-lloj fatkeqësish të shumta natyrore. Pra, ky fenomen natyror i përsëritur dy herë në vit nuk qenka kot e as rastësi që përsëritet vazhdimisht, sepse rastësitë ndodhin rrallë, kurse ky fenomen ndodh shpesh. Kjo na tregon se Allahu është duke përgatitur dënimin për mëkatarët, bile atë është duke ua dhënë atyre edhe në këtë botë që ta shijojnë sado pak e ndoshta kthehen në rrugën e Tij. Por më kot, sepse ata që sytë, veshët dhe zemrat i kanë të mbyllura nuk mund të kuptojnë.

Hadithi na jep të kuptojmë, se bota nuk ka nevojë të shqetësohet për nxehtjen globale, as nuk ka nevojë të ndajë fonde për studimin e këtij problemi apo për zgjidhjen e tij. Shkaku i tij dihet fare qartë, gjithashtu edhe më qartë dhe i sigurt dihet zgjidhja e këtij problemi. E vetmja rrugë për shpëtim nga këto dy dënime është kthimi tek rruga e Zotit, tek rruga e Atij që e ngroh dhe e ftoh xhehenemin.

Me këtë hadith i Dërguari, salallahu alejhi ue selem, para katërmbëdhjetë shekujsh i tregoi botës për problemin e ngrohjes globale, por jo vetëm kaq, ai salallahu alejhi ue selem, u tregoi atyre edhe zgjidhjen e këtij problemi. Prandaj askush nuk ka nevojë ta studiojë çështjen së dyti, sepse edhe problemi edhe zgjidhja janë të ditura, e ajo është kthimi tek Allahu dhe largimi nga mëkatet. ■

PREZANTIM I LIBRIT:

NGJARJET E POPUJVE TË HERSHËM



Titulli i plotë: **NGJARJET E POPUJVE TË
HERSHËM NË HADITHET E PROFETIT**
(pajisur me dobi dhe mësim)

Botoi: **Jehona, Tiranë, Korrik 2008**

Faqe: **214, kopertina të forta**

SHKRUAN: RAMADAN RAMADANI

Shumë lexuesve të koleksioneve të haditheve mund t'u kishte shkuar mendja që të kenë të përmbledhur në një libër të gjithë hadithet me rrëfimet që tregohen nga Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, për popujt dhe njerëzit e mëparshëm. Sidomos duke pasur parasysh që këto hadithe janë plotë me dobi dhe mësim që mund të nxjerrim nga to. Gjatë brezave të ndryshëm ka pasur dijetarë që në kësi

librash kanë përmbledhur rrëfime nga hadithet, por ajo që ka qenë e dukshme gjatë leximit të tyre është se ato rrëfime janë sjellë pa verifikimin e duhur për saktësinë e haditheve që sillen në këto libra. Sidomos ka qenë e pranishme frika nga futja e israilijateve-tregimeve të përcjella nga Beni Israilët, në mënyrë të paverifikuar dhe duke dashur të jepen më shumë hollësi rreth disa ndodhive në historinë e popujve dhe civilizimeve të mëhershme. Mendojmë se me paraqitjen e disa librave nga autorë bashkëkohës në të cilët përveç se përmbledhen hadithet, që

përmbajnë në vete rrëfime, kanë dhënë edhe mundin e duhur në verifikimin e tyre, si dhe nxjerrjen e dobive nga këto hadithe. Kështu u plotësua edhe ky boshllëk dhe tani lexuesi ka mundësinë për të pasur një qasje të përmbledhur mbi këto hadithe. Por kjo zgjidhje ekziston për nxënësit e dijes dhe për ata që mund të shërbehen me arabishten. Kurse në shqip tani është plotësuar ky boshllëk dhe deri në mundësinë e zgjedhjes së librit, që po prezantojmë në këtë shkrim është më se i mjaftueshëm. Zgjedhja që ka bërë për ne botuesi dhe përkthyesi, që të na sjellë në shqip këtë libër është zgjidhje e qëlluar.

Zgjedhja që kanë bërë botuesit dhe përkthyesi meriton lëvdata të posaçme pasi ka pasur edhe libra të tjerë në këtë temë, të cilat ndoshta janë më të lehta për lexim dhe më të pasura me dobi dhe mësim të nxjerra prej haditheve, por gjithsesi ju mungon verifikimi i teksteve të hadithit. Krahasimi që kam parasysh bëhet me një libër tjetër të ngjashëm që kemi lexuar për këtë temë; i përpiluar nga Shejh Omer Sulejman El Eshkar e që në origjinal titullohet Sahihul Kisinin Nebij (Rrëfime të vërteta nga hadithet peygamberike).

Libri që po prezantojmë është një prej studimeve të para në këtë lëmi, të njërit prej nxënësve më të vyer të shejh Nasirudin Albanit, dijetarit të mirënjohur për nxënësit e dijes fetare: shejh Meshhur Hasan Selmanit.

Përparësia e këtij libri përveç se në përzgjedhjen e temës dhe përmbledhjen e haditheve që kanë për bazë ndodhitë e popujve të mëhershëm është edhe në studimin dhe verifikimin e tyre.

Libri i shejh Meshhurit, që tani është edhe në shqip e përmbush plotësisht këtë mungesë të literaturës së verifikuar për ndodhitë që rrëfehen në hadithet e

Pejgamberit salallahu alejhi ue selem. Ndonëse libri në përkthimin në gjuhën shqipe i janë shkurtuar disa fusnota dhe referenca, gjë për të cilën e sqaron përkthyesi, sërish ky libër është shumë i pasur me shënime anësore që ndihmojnë leximin e librit, por edhe referimin në tekstet origjinale të haditheve nëpër koleksionet e hadithit. Ndoshta do të kishte qenë edhe më mirë që të gjendej vend edhe për tekstin origjinal të haditheve në botimin në shqip, pasi mendojmë se botimi me kopertinë të trashë dhe në frymë klasike do të meritonte ca faqe tepër për hadithet në origjinal, sidomos nëse kihet parasysh se libri do të mund të shfrytëzohet nga shumë hoxhallarë dhe nxënës të dijes për ligjëratat dhe këshillime fetare. Por gjithsesi referencat e bëjnë të lehtë çdo konsultim me origjinalin e teksteve në arabisht.

Kështu që çdokush që ka dëshirë të ketë në një libër të gjithë hadithet, që rrëfejnë për ndodhitë e popujve të mëparshëm, gjithë ata që duan të dinë një përkthim më sqarues në shqip të këtyre haditheve, por edhe gjithë ata që duan të lexojnë rrëfime të vërteta, duke mos u brengosur për vërtetësinë e tyre, tani kanë mundësinë të lexojnë këtë libër, i cili mjafton. Po në përkthimin e këtij libri në shqip vërehet një gjuhë shqipe e mirë, që është fryt i mundit të përkthyesit dhe redaktorit gjuhësor. Dhe çdokush që dëshiron të krahasojë këtë gjuhë dhe këtë përkthim atë shumë lehtë mund ta bëjë duke lexuar hadithin e Umu Zerit në këtë libër. ■

FETVA DHE UDHËZIME RRETH STINËS SË DIMRIT



PËRGATITI: ALI SHABANI TANUSHA

Pyetje 1: A e ka përmendur Allahu në Kuran, apo Pejgamberi salallahu alejhi ue selem, dimrin, apo diçka në lidhje me dimrin?

Përgjigje: Edhe pse në shumë vise e sidomos tek ne dallojmë katër stine gjatë vitit pranverën, verën, vjeshtën dhe dimrin, te pleqtë hasim se vitin e kanë ndarë në dimër

dhe verë. E njëjta gjë ka ndodhur tek arabët. Allahu në suren Kurejsh i përmend të dy stinët, dimrin dhe verën: ***“Për hir të garantimit që gëzojnë kurejshitët! Garantimin e udhëtimit të tyre të lirë dimrit dhe verës!”***, që nënkuptohet se pranvera dhe vera janë një periudhë dhe vjeshta me dimrin janë një periudhë tjetër, kështu që reshjet, si shiu, bora, breshëri etj., që përmenden në tekstet Kuranore dhe në hadith kanë të bëjnë me stinën e dimrit.

Me këtë gjë dua të bëj një vërejtje, se kemi

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në revista@albislam.com

hasur tek të vjetrit tanë, se fillimin e periudhës dimërore e kanë quajtur **Shmitër** (Shën Mitër), ndërsa atë verore Shën Gjergj, e këtë të fundit edhe e kanë festuar nëpërmjet manifestimeve të ndryshme, po edhe me disa besëtytni. Dua që t'ua tërheq vërejtjen për këto vepra të injorancës dhe nuk i takon muslimanit, që t'i emërtojë kohët apo vendet me emra të mushrikëve.

Pyetje: Çfarë mund të na përmendni nga ato tekste në lidhje me dimrin?

Përgjigje: Allahu i madhëruar ka përmendur në Kuran në suren Rad (murmurima-bubullima) murmurimën dhe se ajo e madhëron Zotin Fuqiplotë. Ka përmendur edhe rrufenë dhe vetëtimën: **“Ndërkaq, murmurima e madhëron (Zotin një) me falënderimin (që i takon) e Tij, (e madhërojnë) edhe engjëjt nga droja ndaj Tij. E Ai dërgon rrufetë dhe me ato godet kë të dojë. Ndërsa idhujtarët polemizojnë rreth Allahut, e Ai është ndëshkues i rreptë.”** Shkaku i zbritjes së këtij ajeti ka qenë se një njeri nga paria e mushrikëve ka polemizuar dhe i ka thënë Pejgamberit, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te: Kush është Zoti yt tek i cili po më ftoni ju? A është prej hekuri? Apo mos është prej bakri? Prej argjendi? Apo ari? -Në këtë çast Allahu i dërgoi rrufetë dhe ia dogji atij kokën.

Ibën Abasi rrëfen se një ditë kanë ardhur disa çifutë tek i Dërguari i Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, dhe e kanë pyetur: O Ebu Kasim, na trego për murmurimën, çfarë është ajo? Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, iu tha: **“Ajo është engjëll që është i angazhuar me retë, me vete ka zjarr dhe i çon me to retë nga të dojë”**. Ata pyetën: Çfarë është ky zë që ne e dëgjojmë? **“Qortimi i resë, derisa arrin atje ku e kanë urdhëruar”** – u përgjigj. Ata thanë: Të vërtetën e the. (Silsile Sahiha nr. 1872)

Po ashtu Allahu ka përmendur shiun dhe breshrin në suren Nur, ajeti 43: **“A nuk e ke parë se si Allahu i drejton retë, pastaj i bashkon, i bën grumbull ato edhe atëherë e sheh shiun se si rrjedh prej tyre. Ai lëshon prej së larti, nga retë e mëdha si kodra breshër dhe me te godit këdo, e ia largon atij që do. Shkëlqimi i vetëtimës së resë gati sa s'ta merr shikimin”**.

Nga tekstet ku përmendet dimri kemi edhe hadithin që përcjell Buhariu dhe Muslimi në Sahihët e tyre nga Ebu Hurejre, Allahut qoftë i kënaqur me te, se Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, ka thënë: **“Zjarri iu ankua Allahut duke i thënë: “O Zot, jam duke u ngrënë ndër vete (po zihem me veten)”. Atëherë Allahu i lejoi që ta lirojë veten dy herë në vit, një në verë e tjetrin në dimër. Prandaj nxehtësinë më të madhe që e ndjeni në verë është shfryrje (frymënxjerrje) e zjarrit të xhehenemit, kurse të ftohtin e madh që e ndjeni në dimër është nga shfryrja (frymënxjerrja) e të ftohtit të xhehenemit”**.

Po ashtu në ndryshimin e klimës ka edhe urtësi për ata që meditojnë. Njëri nga selefët ka thënë: **Çdo herë që e kam parë borën duke rënë kam kujtuar fletushkat në Ditën e Kijametit**.

Pyetje: Shpeshherë dëgjojmë nga njerëzit kur vjen stina e dimrit të shprehin fjalë që aludojnë në mosdashjen e kësaj stine, si për shembull: “I kisha dhënë shtatë dimra për një verë” dhe fjalë të ngjashme si kjo. Çfarë do të na thoni rreth kësaj shprehje, sa është me vend të shprehim kesi fjalësh?

Përgjigje: Këto shprehje nuk duhet të dalin nga gojë e besimtarëve, se çdo gjë që e ka krijuar Allahu ngërthen në vete urtësi dhe mësim për ata që mendojnë. Megjithatë, këto shprehje dalin më shpesh nga skamnorët për mungesat që ndjejnë në

stinën e dimrit të mjeteve materiale, si për ngrohje, rroba e kështu me radhë. Kur kthehemi te fjalët e **të parëve tanë**, vërejmë se ata nga këndvështrimi i tyre për këtë stinë janë gëzuar.

Omer b. Hatabi, Allahut qoftë i kënaqur me te, ka thënë: “Dimri është si pre për adhuresit e Allahut”.

Abdullah b. Mesudi ka thënë: “Mirë se të vijë dimri. Në të zbret bereqeti, në të zgjartet nata për namaz nate, shkurtohet dita për agjërim”.

Hasan Basriu ka thënë: “Sa kohë e mirë është dimri për besimtarin, netët i ka të gjata për t’u falur natën dhe ditët i ka të shkurtra për të agjëruar”.

Pyetje: Bora a është e pastër dhe a mund të merret abdes me borë?

Përgjigje: Çdo reshje nga qielli është e pastër dhe mund të përdoret për abdes. Allahu i Madhëruar ka thënë: “**...dhe Ne lëshuam prej qiellit ujë të pastër**”. Furkan 48. Ky ujë nga qielli bien në tokë në disa forma varësisht nga klima. Nëse është më ngrohtë bien si shi e nëse është më ftohtë bien, si breshër apo si borë. Të gjitha këto janë të pastra dhe pastruese.

Pyetje: Meqë dimri është stinë e ftohtë dhe bën acar sidomos në viset tona, a ka lehtësime për besimtarët në zbatimin e dispozitave fetare?

Përgjigje: Allahu i Madhëruar e ka zbritur këtë fe me lehtësime dhe tolerancë. Allahu i Madhëruar na thotë: “**...Allahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju**.” Bekare 185. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, ka thënë: “Me të vërtetë kjo fe është e lehtë”. Po ashtu ka thënë: “Unë jam dërguar me fenë e pastër (pa shirk) dhe tolerante”. Po ashtu ka thënë: “Me të vërtetë Allahu dëshiron t’i pranoni lehtësimet e Tij, ashtu siç dëshiron

t’i praktikoni detyrimet e Tij”.

Prej lehtësimeve që i ofrohen besimtarit në këtë stinë është mes’hi mbi meste, apo çorape që e mbulojnë këmbën deri mbi zogun e këmbës. Lehtësimi tjetër është se besimtarët në kohë me reshje, apo të ftohtë i madh, apo fryn erë e fortë dhe ngjashëm me to, iu lejohet atyre t’i bashkojnë namazet, drekën më iqindinë dhe akshamin me jacinë.

Pyetje: Në këtë stinë bën ftohtë dhe ndonjëherë shkakton te besimtarët të ndeshen me disa ndalesa fetare. Çfarë duhet të ketë parasysh besimtari që mos të bjerë në kundërshtim me ndalesat e Fesë.

Përgjigje: Nga vërejtjet që kemi për besimtarët në këtë stinë është së pari, gjatë marrjes së abdesit. Nuk duhen bërë lëshime në larjen e gjymtyrëve, por ato duhen larë mirë dhe me kujdes. Disa nga besimtarët mbajnë shalle dhe i mbyllin gojët e tyre që t’i mbrojnë nga të ftohti, mirëpo kur të falen ata duhet t’i zbulojnë gojët e tyre, se Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, e ka ndaluar të mbështillet goja gjatë namazit. Po ashtu gjatë faljes nuk duhet të drejtohemi nga zjarri, apo aparateve nxehëse, që përngajnë me zjarrin, sepse Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, e ka ndaluar të falemi në drejtim të zjarrit.

Vërejtja tjetër është se Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, na e ka tërhequr vërejtjen nga zjarri, që mos ta lëmë të ndezur gjatë natës, se mund të ketë pasoja të rrezikshme. Pejgamberi, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi te, ka thënë: “Me të vërtetë zjarri është armiku juaj, prandaj kur të flini, fikenit!”. ■

MUSAI ALEJHI SELAM DHE DITA E ASHURAS

Në muajin Muharrem, gjegjësisht ditën e dhjetë të këtij muaji Allahu i Madhëruar e ndihmoi Musain dhe muslimanët që ishin me të, kurse faraonin dhe ithtarët e tij i fundosi në det

ABDULADHIM BEDEVIJ

Abdullah b. Abasi përcjell se “Muhamedi, salallahu alejhi ve selem, kur shkoi në Medine aty gjeti çifutët që po agjëronin Ditën e Ashuras. Ai i pyeti ata: *Përse agjëroni këtë ditë?* Kjo është një ditë madhështore, në të Allahu e shpëtoi Musain dhe popullin e tij. Musai e agjëroi këtë ditë si shenjë falënderimi ndaj Zotit, prandaj edhe ne e agjërojmë, -iu përgjigjën ata. Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, tha: *Neve na takon më parë pasimi i Musait se sa juve, kështu që urdhëroi të agjërohet ajo ditë.*”

Vërtet Allahu i ndihmon miqtë e Tij në çdo kohë dhe në çdo vend. Kjo në fakt është ndihmë që i jepet të vërtetës dhe poshtërim për të kotën.

Në muajin Muharrem, gjegjësisht ditën e dhjetë të këtij muaji Allahu i Madhëruar e ndihmoi Musain dhe muslimanët që ishin me të, kurse faraonin dhe ithtarët e tij i fundosi në det.

Shpëtimi që i bëri Allahu, Musait dhe besimtarëve dhe fundosja e faraonit ishte një begati, që duhej të falënderohet për të. Për këtë arsye Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, u tha çifutëve: *“Neve na takon më parë pasimi i Musait se sa juve, kështu*

që urdhëroi të agjërohet ajo ditë”. Ai shtoi *“Shpresoj tek Allahu që (me agjërimin e kësaj dite) të na i falë mëkatet e vitit të kaluar.”*

Në këtë tregim të Musait me faraonin ka shumë mësim, prandaj në shumë vende është përmendur në Kuran, madje kur Muhamedi, salallahu alejhi ue selem, dëmtohej ai thoshte: *“Allahu e mëshiroftë Musain, ai u dëmtua edhe më tepër mirëpo bëri durim”*.


Tregimin po e fillojmë si vijon:

Jakubi, alejhi selam, ai që njihet me emrin Israil u shpërngul në Egjipt me djemtë e tij me kërkesën e djalit të vet Jusufit, meqë kishte marrë postin e vezirit. Numri i tyre ishte i kufizuar. Jusufi, alejhi selam, i strehoi duke iu thënë: *“Me dëshirën e Allahut hyni në Egjipt të sigurt!”* (Jusuf: 99)

Për hir të Jusufit, që gëzonte pozitë të lartë te mbreti, familja e tij u nderua dhe mori poste të larta në atë vend.

Kaluan shumë vite dhe izraelitët u shtuan. Faraonët filluan t'i kenë zili për shkak të arritjeve të tyre, prandaj filluan t'i shkarkojnë nga postet dhe t'ua marrin përgjegjësitë.

Një ditë prej ditëve faraoni pa një ëndërr, e cila iu komentua se shkatërrimi i



tij do të vinte nga dora e një fëmije, që do të lindi nga gjiri i izraelitëve. Kjo gjë e hidhëroi atë shumë, prandaj urdhëroi që të vritet çdo i porsalindur nga izraelitët, kurse të rriturit e tyre i shfrytëzonte për të kryer punë të rënda fizike. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: **“Me të vërtetë, faraoni ka ngritur kokën lart në tokë, dhe banorët e saj i kishte përçarë në grupe; disa prej tyre i përndiqte, ashtu që djemtë e tyre ua vriste, e vajzat e tyre ua linte gjallë. Vërtet, ai ishte keqbërës.”** (Kasas: 4)

Mirëpo faraoni deshi një gjë e Allahu deshi një tjetër: **“E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues. Dhe atyre t’u japim pushtet në tokë, e faraonit, Hamanit dhe ushtrisë së këtyre dyve t’ua**

tregojmë atë që i ruheshin (ia kishin frikën).” (Kasas: 5-6)

Në këto rrethana u lind Musai, alejhi salam, kurse nëna e tij e trishtuar u inspirua nga Allahu: **“Vëre atë** (fëmijë, Musain) **në arkë, e mandej hidhe në lumë e lumi e hedh në breg, atë e merr armiku Im dhe i tij.”** (Taha: 39)

Lajmërimet ishin shpallur, urdhrat ishin lëshuar për therjen e çdo fëmije që do të lindej nga mesi i izraelitëve, sepse parashikohej se do vinte dikush, që do të shkatërronte faraonin.

Fuqia hyjnore e çoi këtë fëmijë krejtësisht të pafuqishëm mu te faraoni, i cili filloi të kërkojë mëndeshë për këtë foshnje. Mirëpo fëmija nuk pranoi gjirin e asnjërës derisa iu soll nëna e tij: **“...që ajo**

të jetë e kënaqur e jo e pikëlluar dhe që ta kuptojë ajo se premtimi i Allahut është i vërtetë e i sigurt, por shumica e tyre nuk e dinë." (Kasas: 13)

Musai rritej në pallatin e faraonit, nën kujdesin e tij, duke iu plotësuar të gjitha nevojat që më pas: *"Ai t'u bëhet atyre armik e dëshpërim. Vërtet, faraoni, Hamani dhe ushtria e tyre ishin kundërshtarë"*. (Kasas: 8)

Koha e gjdhënies po edhe e fëmijërisë kaloi, kështu që Musai u rrit me trup dhe arriti pjekurinë mendore, kurse Allahu i dha pushtet e dituri.

Një ditë prej ditëve duke shëtitur në qytet, në kohën kur të gjithë pushonin, ai hasi në dy njerëz që përлахeshin: *"...Njëri prej ithtarëve të tij e tjetri prej armiqve të tij, e ai i anës së tij i kërkoi ndihmë kundër armikut dhe Musai i ra me grusht e ai vdiq."* (Kasas: 15)

Pas këtij rasti të gjithë vendosën, që Musai të vritet, prandaj dikush e këshilloi atë që të iki nga ai vend dhe ai u largua *"prej aty i frikësuar e duke pritur (se ç'po ndodh)"*. (Kasas: 21)

Kur arriti në Medjen iu afrua një burimit për të pirë ujë. Aty gjeti *"...një grumbull njerëzish që po i jepnin bagëtisë ujë, e pak më larg prej tyre vërejt dy gra që po i ndalnin (kafshët e tyre) e u tha: "Si është puna e juve dyjave?" Ato që të dyja i thanë: "Ne nuk u japim ujë deri sa të largohen barinjët, kurse babai ynë është shumë i vjetër!"* Atëherë ai u dha ujë kafshëve të tyre, pastaj u largua anash nën një hije e tha: *"O Zoti im, unë kam nevojë për çfarëdo që të më japësh!"* E njëra prej tyre shkoi tek ai, ecte e turpshme, e i tha: *"Babai im të thërret që të paguajë ty shpërblimin për atë që na u dhe bagëtisë ujë!"* E kur shkoi Musai tek ai dhe ia tregoi atij ngjarjen, ai tha: *"Mos ki frikë, paske shpëtuar nga populli zullumqar!"* Njëra

prej atyre të dyjave tha: *"O babai im, merre këtë në shërbim me pagë, pse më i miri i atij që do ta marrësh në shërbim është ai i fuqishmi e besniku!"* Ai (Shuajbi) tha: *Unë dëshiroj të martoj ty me njërën prej këtyre dy vajzave të mia, me kusht që të më shërbesh tetë vjet, e nëse i plotëson dhjetë, ai është vullneti yt, e unë nuk dëshiroj të të rëndojë ty, e në dashtë Allahu, ti do të gësh tek unë mirëkuptim!"* Ai (Musai) tha: *"Kjo le të mbetet mes meje e teje, e cilindo afat që do ta kryej nga këta të dy, nuk do të ketë më përgjegjësi për mua. Për këtë që po themi Allahu është garant"*. (Kasas: 23-28)

Pasi Musai e plotësoi afatin e tij, kërkoi leje nga miku që të kthehej në Egjipt. Ky në fakt ishte caktim i Allahut, të cilin Allahu i Madhëruar e përmend kështu: *"Ti qëndrove me vite ndër banorët e Medjenit, e pastaj erdhe, o Musa, në kohën e caktuar."* (Taha: 40)

Rrugës, koha ishte shumë e ftohtë, zjarr nuk kishte dhe e humbi orientimin. Ndërsa ishte në këtë gjendje ai pa *"...një zjarr, e i tha familjes së vet: "Rrini ku jeni, se vërejt një zjarr, e unë ndoshta do t'ju sjellë ndonjë gacë prej tij, ose do të gjejë te zjarri ndonjë udhërrëfyes."* (Taha: 10) Kur iu afrua zjarrit *"...u thirr: "O Musa!"* Vërtet, vetëm Unë jam Allahu, nuk ka zot tjetër pos Meje, pra, Mua më adhuro dhe fal namazin për të më kujtuar Mua." (Taha: 11), që nga ky çast Musai, alejhi selam, bëhet pejgamber, pra që kur Allahu i thotë: *"Shko te faraoni se ai ka ngritur kokë"*. (Taha: 24)

Musai i kërkoi Allahut një ndihmës, ai i tha: *"Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim! Dhe më lehtëso në këtë punë timen! Ma zgjidh nyjën e gjuhës sime! Që ta kuptojnë fjalën time! Më cakto një ndihmëtar nga familja ime, Harunin, vëllain tim."* (Taha:

25-30)

Allahu i tha: **“Shko me argumentet e Mia, ti dhe vëllai yt, e mos e hiqni prej kujdesit të përmendurit ndaj Meje. Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.”** (Taha: 43-44)

Fjalët e buta nuk nxisin kryeneçësinë, as mendjemadhësinë me të cilën jetojnë tiranët, prandaj Musai urdhërohet me këto fjalë, sepse detyra e tij ishte të zgjojë zemrën e faraonit, ndoshta do të kthehej ai në të drejtë.

Nëse Musai, që ishte i pagabueshëm dhe i ndihmuar nga Allahu u urdhërua që t'i drejtohej faraonit me fjalë të buta, ç'të mund të thuhet për të tjerët, që nuk i kanë këto përparësi e megjithatë janë të vrazhdë në thirrjen e tyre?!...

Musai mori vëllanë e tij Harunin dhe shkuan te faraoni dhe i thanë atij: **“Ne jemi të dërguar nga Zoti i të gjitha botëve.”** (Shuara: 16) dhe prej tij kërkuan: **“T'i lejosh Beni Israilët të vijnë me ne!”** (Shuara: 17)

Herën e fundit që faraoni e kishte parë Musain ishte qëndrimi i tij në pallatin e vet, e tani kishte një dallim të madh me këtë kërkesë me të cilën po i drejtohej, prandaj faraoni i tha: **“A nuk të rritëm ty si fëmijë në mesin tonë, ku i kalove disa vjet të jetës sate. Dhe ti e bërë atë punë që e bërë, pra, ti je mohues (i të mirave që t'i bëmë).”** (Shuara: 18, 19) Musai ia kthen: **“(Musai) Tha: “E bëra atë, atëherë kur isha i pavetëdijshëm. Prandaj edhe ika prej jush kur u frikësova e Zoti im më dhuroi urtësi dhe më bëri nga të dërguarit. Më përmend atë të mirë që ma bërë mua, e ti i robërove Beni Israilët!”** (Shuara: 21-22)

Pas kësaj faraoni filloi të pyesë me tallje për realitetin e besimit të Musait duke thënë: **““E cili është ai zot i botëve (që ju dërgoi)?” Ai i tha: “Zoti i qiejve dhe**

i tokës dhe ç'ka ndërmjet tyre, nëse bindeni!” Ai (faraoni) atyre që ishin përreth u tha: **“A nuk e dëgjoni?!”** Ai (Musai) tha: **“Zoti juaj dhe i prindërve tuaj të parë!”** (Faraoni) Tha: **“Vërtet, i dërguari juaj që u është dërguar juve, me siguri është i çmendur!”** (Musai) Tha: **“Zot i lindjes dhe i perëndimit dhe ç'ka ndërmjet tyre, po qe se kuptoni!”** (Faraoni) Tha: **“Nëse ti beson zot tjetër pos meje, do të gjendesh në mesin e të burgosurve!”** (Musai) Tha: **“A edhe nëse të sjell ndonjë argument të qartë!”** (Shuara: 23-30) Musai, alejhi salam, e solli bisedën në atë gjendje, që ai të kërkojë argumente, prandaj faraoni tha: **“Ai tha: “Sille pra, nëse thua të vërtetën?” Atëherë (Musai) e hodhi shkopin e vet, i cili u shndërrua në gjarpër të vërtetë. Nxori dorën prej xhepit, kur qe, ajo në sy të shikuesve flakëronte nga bardhësia.”** (Shuara: 31-33)

Kur pa fuqinë e mrekullive të Musait, faraonin e kaploi frika dhe i tha parisë së tij: **“Vërtet, ky qenka magjistar shumë i aftë! Që me magjinë e vet dëshiron t'ju dëbojë nga toka juaj, e ç'më propozoni mua?”** (Shuara: 34,35) Ata i propozuan që të lënë një takim për ta parë, se kush i ka argumentet më të forta, prandaj: **“Magjistarët u tubuan në kohën e ditës së caktuar. Edhe popullit i tha: “Ejani e tubohuni, ashtu që t'i përkrahim magjistarët, nëse ata triumfojnë”. E kur erdhën magjistarët i thanë faraonit: “A do të ketë shpërblim për ne, nëse dalim ngadhënjimtarë?”** Ai tha: **“Po, bile ju atëherë do të jeni prej më të afërmev!”** Musai atyre u tha: **“Hidheni atë që keni për ta hedhur!”** E ata i hodhën litarët dhe shkopinjtë e tyre duke thënë: **“Për hir të madhërisë së faraonit, ne me siguri do të jemi ngadhënjyes!”** Atëherë edhe Musai e hodhi shkopin e vet, i cili menjëherë gëlltiste gjithë çka kishin improvizuar ata.

Atëherë magjistarët ranë në sexhde (u përlulën). **E thanë:** “**Ne i besuam Zotit të botëve, Zotit të Musait e të Harunit!**” (Shuara: 38-48)

Pas kësaj faraoni gati se nuk çmendet, fillon t’i kërcënojë magjistarët e tij duke u thënë: **“I besuat atij, para se t’ju lejoja unë?!” S’ka dyshim se ai (Musai) është prijësi juaj që ua mësoi juve magjinë, e keni për ta marrë vesh më vonë. Unë do t’ua shkurtoj (do t’ua pres) duart dhe këmbët tuaja të anës së kundërt (kithi) dhe që të gjithëve do t’ju gozhdoj”. Ata (magjistarët) thanë:** **“S’ka rëndësi, ne i kthehem Zotit tonë.”** (Shuara: 49-50)

Në këto çaste, epsharakët nga mesi i popullit të Musait u ndikuan nga paria e faraonit, prandaj filluan të ankohen, mirëpo Musai, alejhi selam i këshilloi që të kenë durim deri sa të vijë urdhri i Allahut: **“Ata (populli i Musait) thanë:** **“Ne ishim të shtypur para se të na vije ti, e edhe pasi na erdhe”. Ai (Musai) tha:** **“Është shpresë se Allahu do ta shkatërrojë armikun tuaj (faraonin), e juve do t’ju bëjë ta zëvendësoni në këtë vend, e do t’ju shikojë se si ju veproni!”** (Araf: 129)

Faraoni vazhdoi me tiraninë e tij, kurse Musai dhe populli i tij përjetonin dënime me durim dhe me shpresë në ndihmën e Allahut. Në këto çaste ndërhyu fuqia e Allahut, prandaj: **“Atëherë (për shkak të mohimit) Ne lëshuam kundër tyre: vërshimin, karkalecat, rriqrat, bretkosat dhe gjakun, fakte të qarta njëra pas tjetrës, po ata tregonin kokëfortësi, sepse ishin popull mëkatar.”** (Araf: 133) Mirëpo ata nuk merrnin mësim, madje e pohuan qartë: **“Me çfarëdo argumenti të na vish, që me të të na magjepsësh (largosh nga feja që kemi), ne nuk do të besojmë ty”.** (Araf: 132)

Musai e kuptoi se nuk kishte më shpresë për kthimin e tyre, prandaj Allahu

i shpalli atij: **“Tërhiqu me robërit e Mi natën, se do të jeni të ndjekur. Dhe lëre detin ashtu të qetë (të hapur), se ata janë ushtri që do të përmytet.”** (Duhan: 23)

Në natën e caktuar doli Musai me popullin e tij për t’u larguar nga Egjipti. Faraoni e kuptoi këtë gjë, prandaj e tuboi ushtrinë dhe iu vihët prapa: **“E ata (të faraonit) i arritën (Beni Israilët) në kohën e lindjes së diellit. Dhe kur u panë të dy grupet, shokët e Musait thanë:** **“Me siguri na zunë!” Ai (Musai) tha:** **“Kurrsesi, me mua është Zoti im, Ai do të më udhëzojë”. Ndërsa Ne Musait i thamë:** **“Me shkopin tënd bjeri detit”. Deti u nda dhe çdo pjesë u bë si kodër e madhe.”** (Shuara: 60-63)

Musai kaloi me popullin e tij, kurse faraoni duke qenë në mes të detit të ndarë **“...e përfshiu atë përmytja, e ai tha:** **“Besova se nuk ka zot tjetër pos Atij që i besuan Beni Israilët, edhe unë jam nga muslimanët!”** (Junus: 92)

Atij i thuhet: **“Ti tani beson, ndërsa më parë kundërshtove dhe ishe njëri prej shkatërruesve!”** (Junus: 93)

Ibën Abasi rrëfen se Pejgamberi, salallahu alejhi ve selem, ka thënë: **“Xhibrili më ka thënë: Në ato çaste të më shihje se si merrja pjesë të detit për t’ia zënë frymën faraonit, nga frika që të mos mëshirohet.”**

Kështu Allahu e shpëtoi Musain dhe e fundosi faraonin e **“u plotësua fjala më e mirë (premtimi i vërtetë) e Zotit ndaj Beni Israilëve; rrënuam atë që bënte faraoni i tij, si dhe atë që kishin ndërtuar ata.”** (Araf: 137) **“Vërtet, në këtë (ngjarje) ka fakte, por megjithatë shumica nuk besuan. Nuk ka dyshim se Zoti yt është i Gjithëfuqishëm dhe i mëshirshëm.”** (Shuara: 67-68)

Lum për ata që kanë durim! ■

Përktheu: Agim BEKIRI